



## Familjet ushtarake, histori suksesi dhe sakrifice

Intervistoi: **Anjeza MUSOLLARI**

*Intervistë me kolonele Majlinda Sallakun*

**M**ajlinda Sallaku, vajza nga qyteti i bukur i Çorovodës, vendosi të ndjekë Akademinë Ushtarake "Skënderbej", si ëndërr të hershme të fëmijërisë së saj. Majlinda përfundoi me arritje të larta studimet, dhe nisi jetën si ushtarake, ku njëkohësisht do të gjente dhe dashurinë e saj të përjetshme, bashkëshortin dhe babanë e fëmijëve të saj. Përkrah

bashkëshortit të saj, (të ndjerit) gjeneral brigade Ndriçim Sallakut, ata do të vazhdonin udhëtimin e tyre jetësor dhe profesional mes dashurish dhe sfidash. Që prej ditës së parë kur veshi uniformën e deri sot ajo ngelet e shenjtë në familjen e tyre. Majlinda, duke iu përkushtuar me dashuri profesionit të zgjedhur, punës së palodhur, ngjiti shpejt,

me meritë shkallët e karrierës. Pasi kreu Akademinë e Luftës të Forcave Tokësore në Stamboll vazhdoi të përfaqësojë diplomacinë ushtarake të Shqipërisë në Republikën e Turqisë. Rasti i Majlindës e bashkëshortit të saj, gjeneral brigade Ndriçim Sallakut, është një ndër shembujt më të bukur, më domethënës, kur çifti ka ndjekur hap pas hapi...

» faqe 6-7



## Takimi i ministrave të Mbrojtjes të vendeve të NATO-s, Bruksel

## Ministri Peleshi: Projekti i ri i Porto Romanos do të ofrojë infrastrukturë të dedikuar ushtarake për FA-të dhe NATO-n



» faqe 3

### Ministri Peleshi: Shqipëria drejt anëtarësimit në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së

**M**inistri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe drejtori i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, Haki Çako, pritën në një takim në ambientet e Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, Komisionerin Europian për Mbrojtjen Civile, Janez Lenarcic. Takimi u zhvillua në kuadrin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Europian (Union Civil Protection Mechanism/ UCPM). Ky takim u zhvillua...



» faqe 3

### Gjeneralmajor Manushaqe Shehu priti në takim Shefin e ODC nënkolonel Erol Munir

Zëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, priti në takim shefin e Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes (ODC), nënkolonel Erol Munir, me rastin e përfundimit të mandatit të tij në vendin tonë. Në përshëndetjen e saj, gjeneralmajor Shehu falënderoi dhe shprehu konsideratën e saj më të lartë për nënkolonel Munir, për punën e tij të shkëlqyer si shef i Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes si dhe për kontributin e tij në drejtim të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes midis vendit tonë...



» faqe 2

### "Dita e vizitorëve të shquar" e stërvitjes "Adrion Livex-22"

**N**ë përfundim të stërvitjes "Adrion Livex-22" e zhvilluar në Split, Kroaci është zhvilluar "Dita e vizitorëve të shquar", në të cilën morën pjesë përfaqësues të lartë ushtarakë të forcave detare kroate, slovene, greke, italiane, malazeze dhe ato shqiptare. Qëllimi i stërvitjes ishte përmirësimi i ndërveprimit të marinave "Adrion" në kryerjen e operacioneve detare si operacionet e ndalimit detar, kërkim-shpëtim, manovrimi detar, komunikimi si dhe trajnimin e procedurave në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve shumëkombëshe për të forcuar sigurinë e përgjithshme në det. Një pikë tjetër...



» faqe 5

# Ministri Peleshi nënshkruan marrëveshjen në fushën e Mbrojtjes me Letoninë

Ministri i Mbrojtjes, Niko Peleshi ka njoftuar nënshkrimin e marrëveshjes me Letoninë në fushën e Mbrojtjes. Marrëveshja është firmosur gjatë takimit të ministrave të mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s. Peleshi: "Marrëveshja në fushën e mbro-

jtjes ndërmjet Shqipërisë dhe Letonisë e nënshkruar gjatë ministerialit të Mbrojtjes së NATO-s, do të rrisë më tej bashkëpunimin me vendin baltik, ku prej disa vitesh trupat tanë kontribuojnë si pjesë e grup-batalionit të NATO-s.



## Gjeneralmajor Manushaqe Shehu priti në takim Shefin e ODC nënkolonel Erol Munir

**Z**ëvendëshefi i Shtabit të Përgjithshëm i FARSH, gjeneralmajor Manushaqe Shehu, priti në takim shefin e Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes (ODC), nënkolonel Erol Munir, me rastin e përfundimit të mandatit të tij në vendin tonë.

Në përshëndetjen e saj, gjeneralmajor Shehu falënderoi dhe shprehu konsideratën e saj më të lartë për nënkolonel Munir, për punën e tij të shkëlqyer si shef i Zyrës së Bashkëpunimit të Mbrojtjes si dhe për kontributin e tij në drejtim të rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes midis vendit tonë dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ndër të tjera gjeneralmajor Shehu theksoi se: "SHBA-të kanë dhënë një kontribut të veçantë në drejtim të modernizimit të Forcave të Armatosura, duke mbështetur me projekte të ndryshme si: mjetet taktike të blinduara, helikopterët Blackhawk, Bazën Ajrore të Kuçovës, njësinë e Mbrojtjes Kibernetike si dhe mjetet taktike të komunikimit".

Nga ana e tij nënkolonel Erol Munir falënderoi gjeneralmajor Shehun dhe Shtabin e Përgjithshëm për mbështetjen dhe bashkëpunimin e shkëlqyer që është treguar.

Në fund të takimit, gjeneralmajor Shehu i akordoi shefit të Zyrës së ODC, nënkolonel Erol Munir, "Certifikatë Mirënjohje", për kontributin e vyer në bashkëpunimin dhe koordinimin në fushën e Mbrojtjes.



**"SHBA-të kanë dhënë një kontribut të veçantë në drejtim të modernizimit të Forcave të Armatosura, duke mbështetur me projekte të ndryshme si: mjetet taktike të blinduara, helikopterët Blackhawk, Bazën Ajrore të Kuçovës, njësinë e Mbrojtjes Kibernetike si dhe mjetet taktike të komunikimit".**



TAKIMI I MINISTRAVE TË MBROJTJES TË VENDEVE TË NATO-S, BRUKSEL

# Ministri Peleshi: Projekti i ri i Porto Romanos do të ofrojë infrastrukturë të dedikuar ushtarake për FA-të dhe NATO-n

**M**inistri i Mbrojtjes Niko Peleshi mori pjesë në takimin e ministrave të Mbrojtjes të vendeve të Aleancës së Atlantikut të Veriut që u mbajt në selinë e NATO-s, në Bruksel. Në qendër të diskutimeve të këtij takimi ishte forcimi i mëtejshëm i Aleancës dhe vijimi i mbështetjes për vendet partnere të NATO-s, në një kohë që agresioni rus në Ukrainë ka kaluar 100 ditë nga nisja e tij. Këtij takimi iu bashkuan edhe ministrat e Mbrojtjes së Ukrainës, Gjeorgjisë, Suedisë, Finlandës, si dhe Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Europian.

Gjatë fjalës së tij, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh se vendi ynë do të mbështesë dhe kontribuojë në rritjen dhe përforcimin edhe me kapacitete ushtarake të kufijve të Aleancës, në interes të mbrojtjes dhe ruajtjes së popullsisë së saj. Ministri Peleshi foli për projektin e ri të Porto Romanos që do të ofrojë edhe infrastrukturë të dedikuar për Forcat e Armatosura dhe Aleancën e NATO-s. “Ne e vlerësojmë infrastrukturën tonë kritike, jo vetëm nga perspektiva kombëtare, por edhe nga ajo e Aleancës. Në këtë kuadër, duke pasur parasysh vendndodhjen gjeografike, porti i Durrësit shërbeu si një qendër pritjeje e stërvitjes “Defender Europe 2021” gjë që dëshmon se është një pikë strategjike që lidh detin Adriatik dhe Detin e Zi që njihet ndryshe edhe si Korridori 8”, -u shpreh në fjalën e tij ministri i Mbrojtjes Peleshi. Ai tërhoqi vëmendjen në lidhje me efektet që lufta e Rusisë ndaj Ukrainës mund të sjellë në rajonin e Ballkanit. Ministri i Mbrojtjes theksoi rëndësinë që ka në këtë situatë përsheptimi i procesit të integritetit Euro-Atlantik të vendeve të rajonit. Gjithashtu ministri Peleshi tha se është i rëndësishëm dër-



gimi i një mesazhi të fortë se siguria e rajonit të Ballkanit mbetet interes jetik për Aleancën dhe se Rusia me “levat” e saj nuk duhet të lejohet të destabilizojë mbarë rajonin.

Ministrat e vendeve të Aleancës u pritën më herët në një darkë pune nga Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, i cili vlerësoi mbështetjen e pakursyer që vendet aleate dhe partnere të NATO-s kanë dhënë në kapacitete ushtarake, ndihmë financiare dhe asistencë humanitare. Gjithashtu, Ai theksoi se Aleanca është dhe mbetet e vendosur për të vazhduar mbështetjen për Ukrainën, si dhe mbetet optimiste se kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve të Aleancës do të miratojnë një Paketë Asistence Gjithëpërfshirëse gjatë Samitit të Madridit, që është planifikuar të zhvillohet më 29-30 qershor.



UNION CIVIL PROTECTION MECHANISM/UCPM

## Ministri Peleshi: Shqipëria drejt anëtarësimit në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së, hap i rëndësishëm për forcimin dhe bashkëpunimin në nivel evropian

**M**inistri i Mbrojtjes Niko Peleshi dhe drejtori i Agjencisë Kombëtare për Mbrojtjen Civile, Haki Çako, pritën në një takim në ambientet e Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile, Komisionerin Europian për Mbrojtjen Civile, Janez Lenarčič.

Takimi u zhvillua në kuadrin e procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Europian (Union Civil Protection Mechanism/ UCPM).

Ky takim u zhvillua pas takimit të z. Lenarčič me kryeministrin e Republikës së Shqipërisë, Edi Rama, ku u shpreh vullneti i vendit tonë për t'u bërë pjesë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Europian.

Më pas, ministri i Mbrojtjes dhe Komisioneri Europian për Mbrojtjen



Civile të BE-së iu drejtuan ambienteve të Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile.

Gjatë këtij takimi, Peleshi u theksoi se anëtarësimi në këtë mekanizëm është një hap i rëndësishëm për forcimin, bash-

këpunimin dhe bashkërendimin në nivel evropian dhe përmirësimin e sistemit të mbrojtjes civile dhe menaxhimit të

riskut nga fatkeqësitë.

Ministri i Mbrojtjes informoi Komisionerin Europian për Mbrojtjen Civile mbi zhvillimet e fundit dhe reformimin e sistemit të Mbrojtjes Civile në rang kombëtar me synim përballimin sa më efikas të krizave në shkallë të gjerë. Gjithashtu, ministri i Mbrojtjes shprehu mirënjohjen mbi kontributin dhe solidaritetin e treguar nga Mekanizmi i Mbrojtjes Civile i BE-së në momente të vështira që ka kaluar vendi ynë gjatë tërmetit të vitit 2019, pandemisë COVID-19 dhe zjarreve në stinën e verës. Gjatë këtij takimi u theksua fakti se bashkëpunimi midis Shqipërisë dhe këtij mekanizmi në fushën e mbrojtjes civile do të vazhdojë të forcohet në të ardhmen.

Stërvitja

Forca TOKËSORE



Batalioni i Mbështetjes me Luftim i Forcës Tokësore testoi kapacitetet dhe pajisjet e reja për reagimin ndaj armëve të dëmtimit në masë dhe pastrimin e hot-spotëve nga municionet e rrezikshme.

# Batalioni “Komando” zhvillon stërvitjen fushore/ujore “Pashalimani 22-02”



*Batalioni i Mbështetjes me Luftim i Forcës Tokësore testoi kapacitetet dhe pajisjet e reja për reagimin ndaj armëve të dëmtimit në masë dhe pastrimin e hot-spotëve nga municionet e rrezikshme. Në stërvitjen fushore-ujore në Rreth-Greth, trupat praktikuan edhe dhënien e ndihmës së parë në rast mbytjeje.*



## Forca Tokësore, pjesëmarrëse e “Efes-22” në Izmir, Turqi

Në Izmir, Turqi, u zhvillua një nga stërvitjet më të mëdha të vendeve anëtare dhe atyre partnere të NATO-s, e koduar “Efes-22”.

Qëllimi i kësaj stërvitjeje ishte zhvillimi i mëtejshëm i aftësive dhe kapaciteteve ushtarake të trupave “joint”, për të mbuluar dhe realizuar të gjitha detyrat që mund t’iu caktoheshin, duke ruajtur nivelin e gatishmërisë luftarake.

Në këtë stërvitje të përmasave të mëdha, vendi ynë u përfaqësua me një togë këmbësorie nga Batalioni I i Këmbësorisë i Forcës Tokësore. Gjatë stërvitjes, trupat tona treguan nivel të lartë profesionalizmi dhe disipline në realizimin e çdo detyre të caktuar sipas skenarëve të stërvitjes.

Ndër temat kryesore që u zhvilluan gjatë kësaj stërvitjeje ishin: zbarkim nga ajri; qitje me mortaja dhe armë kundërtanke, veprime luftarake nga deti, zbarkim me mjete amfibe etj.

Këtë vit stërvitja “Efes-22”, bëri së bashku mbi 10 000 trupa nga 37 shtete, duke përfshirë ndër të tjerë Shqipërinë, Libinë, Italinë, Azerbajxhanin, Bosnje-Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Pakistanin, Kazakistanin, Kirgistanin,



Shtetet e Bashkuara dhe Francën.

Pjesëmarrja e trupave të Forcës Tokësore në stërvitjen “Efes-22”, vjen në vijim të disa stërvitjeve ndërkombëtare që po zhvillohen këtë vit nga kjo Forcë, në kuadër të plan-kalendarit të stërvitjeve vjetore. Synimi i tyre është rritja e aftësive operacionale dhe ndërvepruese e këtyre forcave në një mjedis operacional ndërkombëtar.



"Ditë e hapur"

AFA



Maturantë dhe qytetarë të shumtë beratas ishin të interesuar për të njohur më shumë detaje mbi të ardhmen e arsimimit po edhe mundësitë e mëdha të punësimit e trajnimit gjatë tërë ciklit jetësor që ofron Akademia jonë Ushtarake.

## Avantazhet

# AFA zhvillon aktivitetin "Ditë e hapur" në Berat

Specialistët e BCU-së të Akademisë së Forcave të Armatosura së bashku me studentë ushtarakë të AFA-së si dhe me ekipin e rekrutuesve të QPR-së zhvilluan në Berat ditë të hapur për promovimin e vlerave me të mira të Forcave të Armatosura dhe veçanërisht me avantazhet që ofrohen nëse një maturant vendos të zgjedhë të ndjekë studimet në Akademinë e Forcave të Armatosura. Maturantë dhe qytetarë të shumtë beratas ishin të interesuar për të njohur më shumë detaje mbi të ardhmen e arsimimit po edhe mundësitë e mëdha të punësimit e trajnimit gjatë tërë ciklit jetësor që ofron Akademia jonë Ushtarake, tashmë e transformuar rrënjësisht sipas modelit të



Akademisë të "West Point" në SHBA. Të rinjtë e të rejat e Beratit ishin të interesuar për degët që ofron AFA, për mundësitë e mësimi të gjuhëve të huaja, për mundësitë

e zhvillimit të karrierës, për pjesëmarrjet në misionet e NATO-s dhe për shumë detaje të tjera nëse do të zgjedhin të bëhen pjesë e Forcave tona të Armatosura.



"Adrion Livex-22"

Forca DETARE



Gjatë zhvillimit të stërvitjes u trajtua rëndësia mbi bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërmjet forcave detare të vendeve të rajonit që lagen nga deti Adriatik dhe Jon.

## Zhvillohet "Dita e vizitorëve të shquar" e stërvitjes "Adrion Livex-22"

Në përfundim të stërvitjes "Adrion Livex-22" e zhvilluar në Split, Kroaci është zhvilluar "Dita e vizitorëve të shquar", në të cilën morën pjesë përfaqësues të lartë ushtarakë të forcave detare kroate, slovene, greke, italiane, malazeze dhe ato shqiptare.

Qëllimi i stërvitjes ishte përmirësimi i ndërveprimit të marinave "Adrion" në kryerjen e operacioneve detare si operacionet e ndalimit detar, kërkim-shpëtim, manovrimi detar, komunikimi si dhe trajnimin e procedurave në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve shumëkombëshe për të forcuar sigurinë e përgjithshme në det. Një pikë tjetër e rëndësishme e stërvitjes ishte trajnimi i ekuipazheve në përdorimin e procedurave standarde të funksionimit sipas manualeve të NATO-s.

Në stërvitjen e zhvilluar në Split Kroaci, Forca Detare mori pjesë me anijen e klasit Iliria "Lissus" P-133.

Gjatë zhvillimit të stërvitjes u trajtua rëndësia mbi bashkëpunimin dhe mirëkuptimin ndërmjet forcave detare të vendeve të rajonit që lagen nga deti Adriatik dhe Jon. Gjithashtu u diskutua mbi rëndësinë e vijimit të iniciativës "Adrion", për rritjen e sigurimit detar të rajonit, për forcimin dhe bashkëpunimin në kuadër të kryerjes së operacioneve të kërkim-shpëtim në det. Në "Ditën e vizitorëve të shquar" mori pjesë komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, i cili pas përfundimit të stërvitjes realizoi dhe një vizitë në bordin e Anijes "Lissus", gjatë takimit përshëndeti efektivin e anijes dhe u shpreh falënderimet për përfaqësimin dinjitoz në këtë stërvitje. Gjithashtu diskutoi për ecurinë e stërvitjes dhe mundësinë e përmirësimit të kapaciteteve operacionale në të ardhmen.



## Zhvillohet Konferenca Përfundimtare për stërvitjen "Imponimi - 2022"

Në Komandën e Forcës Detare u zhvillua konferenca përfundimtare për zhvillimin e stërvitjes "Imponimi - 2022". Konferenca u drejtua nga komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra, i cili theksoi rëndësinë e kësaj stërvitjeje dhe vlerësoi bashkëpunimin e deritanishëm me institucionet shtetërore me interesa të përbashkëta në det. Në konferencë morën pjesë përfaqësues të Shtabit të Forcës Detare, Grupit të Dytë të Anijeve Patrulluese të Flotiljes Detare, Forcës Ajrore, Forcës Tokësore, si dhe përfaqësues të institucioneve detare që do jenë pjesëmarrës në këtë stërvitje me personel e mjete, konkretisht: Qendra Operacionale Ndërinstitucionale Detare, Policia Kufitare e Migracionit dhe Kapitanerisë së Portit Detar Durrës. Qëllimi kryesor i kësaj stërvitjeje është rritja e ndërveprueshmërisë së Forcës Detare me strukturat e Forcave të Armatosura dhe atyre ligj-zbatuese për kryerjen e operacioneve të ndalimit detar si dhe zbatimit të ligjshmërisë detare.



## INTERVISTË ME KOLONELE MAJLINDA SALLAKUN

Familjet ushtarake, histori  
suksesi dhe sakrificeINTERVISTOI:  
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE,  
ANJEZA MUSOLLARI

Majlinda Sallaku, vajza nga qyteti i bukur i Çorovodës, vendosi të ndjekë Akademinë Ushtarake “Skënderbej”, si ëndërr të hershme të fëmijërisë së saj.

Majlinda përfundoi me arritje të larta studimet, dhe nisi jetën si ushtarake, ku njëkohësisht do të gjente dhe dashurinë e saj të përjetshme, bashkëshortin dhe babanë e fëmijëve të saj. Përkrah bashkëshortit të saj, (të ndjerit) gjeneral brigade Ndrim Sallakut, ata do të vazhdonin udhëtimin e tyre jetësor dhe profesional mes dashurish dhe sfidash.

Që prej ditës së parë kur veshi uniformën e deri sot ajo ngelet e shenjtë në familjen e tyre. Majlinda, duke iu përkushtuar me dashuri profesionit të zgjedhur, punës së palodhur, ngjiti shpejt, me meritë shkallët e karrierës. Pasi kreu Akademinë e Luftës të Forcave Tokësore në Stamboll vazhdoi të përfaqësojë diplomacinë ushtarake të Shqipërisë në Republikën e Turqisë. Rasti i Majlindës e bashkëshortit të saj, gjeneral brigade Ndrim Sallakut, është një ndër shembujt më të bukur, më domethënës, kur çifti ka ndjekur hap pas hapi njëri-tjetrin, duke u kuptuar dhe mbështetur pa kushte, sepse profesioni që zgjedhën është profesion që kërkon sakrificë edhe në jetën familjare. Dhe jeta ushtarake e tyre ka kaluar përmes sprovash, mungesash të gjata, apo edhe festime ditëlindjesh të munguara. Vështirësi që nuk i stepën, vështirësi që i motivuan të jenë ku ishte detyra, aty ku flamuri i Shqipërisë duhet të valëvitet krenar.

Sot kolonele Majlinda vazhdon aktivitetin e saj, me dinjitet dhe përkushtim si përfaqësuese e diplomacisë ushtarake të Shqipërisë, në shtetin turk, por sot pa këshilltarin e saj profesional, pa shokun e sfidave, pa babanë e fëmijëve të saj, pa gjysmën e saj më të mirë.

Por e fortë dhe dinjitoze ajo vazhdon përpara për familjen dhe detyrën ndaj atdheut, për të cilën të dy bashkëshortët Sallaku iu përkushtuan me dashuri dhe devotshmëri.

Për të folur për një pjesë të jetës dhe profesionit ushtarak në një intervistë ndryshe vjen për gazetën “Ushtria” kolonele Majlinda Sallaku.

**Si nisi rrugëtimi juaj drejt uniformës ushtarake?**

U linda në Berat, dhe u rrita me shumë dashuri dhe përkushtim të madh nga prindërit e mi në qytetin e bukur të Çorovodës, në një familje me tre fëmijë. Pasi përfundova

*Kolonele Majlinda vazhdon aktivitetin e saj, me dinjitet dhe përkushtim si përfaqësuese e diplomacisë ushtarake të Shqipërisë, në shtetin turk, por sot pa këshilltarin e saj profesional, pa shokun e sfidave, pa babanë e fëmijëve të saj, pa gjysmën e saj më të mirë.*



gjimnazin “Ramiz Aranitasi”, duke menduar të rrezikoja dhe asnjëherë të mos frikësohesha dhe familja ime të ndihej krenare për mua, 33 vite më parë në moshën 18-vjeçare nisi rrugëtimi im drejt uniformës ushtarake, rrugë e gjatë plot sfidë e sakrifica.

**A ishte një ëndërr e juaja kjo?**

Gjithmonë më ka pëlqyer të thyej atë akullin e hershem për femrat, ku profesioni ndahej në “profesion për burra” dhe “profesion për gra”. Ishte ky një motivim dhe një ide e guximshme për kohën, ku duhet të përballesh me sfidën që jeta mund të të sillte përpara. Veshja e uniformës ushtarake ishte një ëndërr, jo vetëm e imja, por e gjithë atyre vajzave

që e shikonin uniformën si simbol krenarie, si një pjesë e rëndësishme e të qenit ushtarak dhe në profesionin e ushtarakut.

**Sa e vështirë ishte të gjeje veten në një ambient ku përqindja e meshkujve është në raport të zhdrejtë me atë të femrave?**

Asokohe ishte krijuar ideja që ushtria ishte vetëm për djem, duke qenë se përqindja e meshkujve ushtarakë ishte në raport të zhdrejtë me atë të femrave, vështirësitë ishin më të dukshme. Ishte ideja e femrave të dobëta fizikisht, që nuk ishin të përgatitura për ushtri, gjë e cila nuk ishte e vërtetë. Ne ishim partnerë të barabartë me meshkujt, ne na bashkonte qëllimi, pasioni, sakrifica, që

të arrinim të bëheshim ushtarakë të suksesshëm, pa dallim gjinie.

**Si ndihet një femër nën uniformën e gjelbër?**

Për mua një femër nën uniformën e gjelbër nuk përbën aspak vështirësi, por një privilegj. Është nder por edhe një sakrificë.

**A është sukcesi i saj tek durimi, që ajo ka më shumë se mashkulli? Çfarë ka një femër më të fortë se një mashkull?**

Që të jesh ushtarak i suksesshëm një nga karakteristikat duhet të jetë durimi, por nuk mendoj që sukcesi i një vajze ushtarake në krahasim me një mashkull është vetëm tek durimi. Këmbëngulja për të arritur qëllimet është një “armë” në duart e një femre

*Sot, që bashkëshorti im nuk jeton më midis nesh, unë kam arritur të kuptoj që përgjegjësia e veprimeve të mia ka qenë ekuilibruese dhe profesionale.*

të fortë.

**Sipas jush, cilat janë parimet në drejtim të suksesit për një grua bashkëkohore?**

Mendoj që parimet në drejtim të suksesit për një grua janë ADN e suksesit, themeli mbi të cilin çdo grua duhet të mbështetet. Morali, performanca, përgjegjshmëria, besimi tek ajo që do të arrish, guximi tek ajo që beson, duke mos u tërhequr, duke u mbështetur fort tek familja, kanë qenë parimet e mia.

**A është objektivizmi i grave një përditshmëri reale?**

Mendoj se po, përpjekja për të vendosur një “status quo”, atë të të quajturit profesionist, ka bërë që shumë vajza, gra apo nëna të kenë karrierë të shkëlqyer në të gjitha fushat: ekonomi, inxhinieri, arsim, mjekësi, shkencë, politikë, pse jo dhe në ushtri.

**Cilat janë sfidat me të cilat një grua duhet të përballë në jetën sociale, për të ruajtur ekuilibrat e saj në jetën private dhe profesionale?**

Unë, si ndër të shumtat gra që kanë veshur rrobat e ushtarakes, jam munduar të ruaj ekuilibrat në jetën private dhe profesionale.

Misioni i të qenit nënë është sfida më e madhe, të qenit të dy të profesionit ushtarak është një sfidë

akoma më e madhe, ndarjet e gjata me Çimin, bashkudhëtarin e jetës sime, në misione dhe shpesh udhëtimet e papritura, puna pa orare, e unë e vetme të përmbushja me sukses rritjen dhe edukimin e fëmijëve, të përballesha me problemet shtëpiake, e më pas me paragjykimet e njerëzve: "...pse ti rri vetëm këtu?", e të tjera si këto. Unë mendoj se të duash familjen në të gjitha dimensionet duhet të sakrifikosh dhe për mua sakrifica është sfidë e madhe.

Sot, që bashkëshorti im nuk jeton më midis nesh, unë kam arritur të kuptoj që përgjegjësia e veprimeve të mia ka qenë ekuilibruese dhe profesionale.

• **Cilat mendoni se kanë qenë arritjet më të mëdha gjatë këtyre viteve?**

Gjatë këtyre viteve kam shënuar arritje të mëdha si në aspektin personal dhe në atë profesional, të cilat më bëjnë sot më shumë se kurrë të jem krenare. Unë dhe bashkudhëtarin i jetës time, si fryt i dashurisë, krijuam familjen tonë të mrekullueshme, aty unë shikoj gjithë përkushtimin, sakrificën e bashkëshortit tim dhe timen, të fëmijëve të mi, që u rritën, u edukuan dhe ecën duke u bërë pjesë e pandarë e sakrificës sonë në profesionin e vështirë të ushtarakut. Unë jam krenare për këtë.

Në aspektin profesional, arritjet janë fryt i sakrificave dhe përkushtimit 30-vjeçar, unë udhëhiqem nga parimi "yes I can" dhe mendoj se përfshirja e një femre në drejtime, në vendimmarrje, në diplomaci është një nga arritjet më të mëdha, që me profesionalizëm jam munduar të mbroj interesat ushtarake dhe të sigurisë së vendit.

• **Po sfida juaj më e madhe?**

Realizimi i të gjitha shkallëve të karrierës ushtarake, plotësimi i detyrës kombëtare, kjo e lidhur ngushtësisht me sfidën e bashkëshortit



tim, i cili gjithë jetën ia kushtoi ushtrisë. Sfidë që përpjekjet e tij të bëhen realitet, që familja jonë të jetë gjithmonë e bashkuar, me çdo lloj sakrifice dhe përkushtimi, ashtu si gjithmonë, pasqyrë e të gjithë asaj që ne ëndërruam, besuam, ndërtuam dhe transmetuam së bashku.

• **Një vit pa bashkëshortin tuaj, babanë e fëmijëve, humbje të tilla e tjetërsojnë jetën, si kanë qenë**

**për ju ditët pa praninë e "shtyllës së familjes"?**

Situatë e trishtë, dhimbje shkatërruese për mua dhe familjen time. U pushtova nga pikëllimi, jeta më përballi me goditje e stuhi të madhe, Çimi për mua nuk ishte vetëm bashkëshort, por bashkudhëtar, shok, e gjithçka në jetë.

• **A keni mundur të ktheni dhimbjen në forcë, kjo dhe për faktin se jeni forca e tre fëmijëve tuaj**

**Klezia, Mandri dhe Ejona, të cilët, si çdo fëmijë, duan buzëqeshjen e ngrohtë të nënës së tyre?**

Jam mjaft e vetëdijshme për faktin e pamohueshëm që jeta ka një fund për çdo qenie njerëzore, por largimi i tij i papritur më ka lënduar shumë. Pas humbjes së njeriut më të çmuar në jetën time, jam përpjekur të jem e fortë para tre fëmijëve të mi, duke marrë frymë thellë...

Tani po përballem me një sfidë

akoma më të madhe, atë të gjetjes së forcës së nevojshme për të mbajtur dhe vazhduar me vendosmëri çdo gjë që arritëm dhe do të arrinim së bashku.

Këtë do ta bëj si nënë e tre fëmijëve, motiv ky për të qëndruar e fortë dhe për të arritur objektivat që kishim së bashku. Ishte, është dhe do të jetë njeriu më i rëndësishëm për mua, familjen dhe shoqërinë. Jam krenare për të.

• **Ëndrra e një nëne në karrierë për fëmijët e saj, është përmbushur?**

Përmbushja e ëndrrës së një nëne për fëmijët nuk është më një ëndërr, falë përkushtimit tim dhe shokut tim të jetës, është tashmë një realitet ku plotësohet çdo ditë dhe jam shumë krenare për këtë.

• **Familja Sallaku do vazhdojë ta trashëgojë uniformën ushtarake?**

Siç e thashë edhe më lart, unë jam nënë e tre fëmijëve Klezia, Mandri dhe Ejona. Klezia ka studiuar për marrëdhënie ndërkombëtare, ndërsa Mandri ka studiuar për turizëm. Ejona, vajza jonë e vogël shpesh herë thotë: "unë do bëhem si babi dhe mami, do bëhem ushtarake që të plotësoj ëndrrën time dhe në të njëjtën kohë të vazhdoj në rrugën e lënë përgjysmë nga babi.

• **Mesazhi juaj për të gjitha vajzat e reja që aspirojnë të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura?**

Profesioni i ushtarakut është tepër fisnik e i vështirë, bart sakrificë dhe rreziqe për të cilat duhet të jemi gjithmonë të përgatitur. Është shumë i vështirë, sidomos për vajzat dhe gratë në uniformë, por me durim, guxim, përkushtim dhe vendosmëri i arrin objektivat për të qenë i suksesshëm në jetë. Zgjidhni me zemër këtë profesion dhe përpikuni të shihni pozitivet në gjithçka!



Ceremonia

Forca **AJRORE**

“Shpesh kur flitet për historikun e aviacionit dhe drejtuesve të saj, emri i komandant Harillës nuk ndahet nga ai i drejtuesve të spikatur, duke mbetur në kujtesën e pilotëve dhe teknikëve, një ikonë e aviacionit ushtarak.

Në qytetin e Gjirokastrës u zhvillua ceremonia e nderimit dhe dorëzimit të titullit “Mirënjohje e Qytetit” për ish-pilotin dhe komandantin e tre ish-regjimenteve të Rinasit, Gjadrit dhe Kuçovës z. Harilla Rebi. Në këtë aktivitet morën pjesë prefekti i Qarkut Gjirokastrë Odise Kote, kryetari i Bashkisë Gjirokastrë Flamur Golemi, përfaqësues të Komandës së Forcës Ajrore, kryetari i Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë gjeneral brigade (R) Astrit Jaupi, përfaqësues të Këshillit të Qarkut Gjirokastrë, pilotë-veteranë të Forcës Ajrore si dhe miq, shokë e familjarë të z. Harilla Rebi.

Ceremonia u hap me kujtimet e pilotit veteran Agim Matraku, i cili prezantoi mes emocionesh gjithë karrierën dhe kontributin e z. Harilla Rebi si pilot dhe drejtues i disa prej njësive kryesore të Forcës Ajrore.

Në emër të Komandës së Forcës Ajrore, fjalën përshëndetëse e mbajti nënkolonela Silvana Lahi, shefja e bashkëpunimit civilo-ushtarak.

Ajo transmetoi urimet e komandantit të Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj, duke theksuar se:



“Shpesh kur flitet për historikun e aviacionit dhe drejtuesve të saj, emri i komandant Harillës nuk ndahet nga ai i drejtuesve të spikatur, duke mbetur në kujtesën e pilotëve dhe teknikëve, një ikonë e aviacionit ushtarak. Si drejtues dhe komandant i tre regjiment-

eve të aviacionit që ai ka drejtuar në Gjadër, Kuçovë dhe Rinas, ka treguar jo vetëm aftësitë më të shkëlqyera të një liderशिpi por edhe fisnikërinë qytetare në marrëdhëniet me njerëzit. Komandant Harilla ishte figura dhe mishërimi më i mirë i ushtarakut



model që udhëhiqej nga moto, se mbi të gjitha është “Atdheu-Detyra-Nderi”. Figura e ish-komandantit dhe pilotit Harilla Rebi është sot një emër i respektuar dhe një model për brezat e rinj të pilotëve që shërbejnë në Forcën Ajrore”.

Ceremonia u mbyll me dorëzimin nga kryetari i Bashkisë të titullit “Mirënjohje e qytetit” z. Harilla Rebi si dhe “Certifikata e Mirënjohjes” dorëzuar nga gjeneral brigade (R) Astrit Jaupi kryetar i Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë.

## Ish-piloti dhe komandanti Shefqet Lata nderohet me titullin “Qytetar nderi i Bashkisë Mat”

Në qytetin e Burrelit u zhvillua ceremonia e nderimit dhe dorëzimit të titullit “Qytetar nderi” për ish-pilotin dhe komandantin e ish-regjimenteve të Gjadrit dhe Rinasit z. Shefqet Lata.

Në këtë aktivitet morën pjesë prefekti i Qarkut Nexhbedin Shehu, kryetari i Bashkisë Mat, Agron Malaj, kryetari i Këshillit të Bashkisë Mat Elisa Gjasta, kryetari i Shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë gjeneral brigade (R) Astrit Jaupi, përfaqësues të Komandës së Forcës Ajrore, 15 anëtarët e këshillit të Bashkisë Mat, pilotë-veteranë të Forcës Ajrore si dhe miq, shokë e familjarë të z. Shefqet Lata.

Ceremonia u hap me vendimin e Këshillit të Bashkisë Mat duke u pasuar me fjalën e pilotit veteran Agim Matraku, i cili prezantoi karrierën dhe kontributin e z. Shefqet Lata si pilot dhe drejtues në vite, i disa prej njësive kryesore të Forcës Ajrore.

Kryetari i Bashkisë Agron Malaj përshëndeti dhe dorëzoi titullin “Qytetar nderi i Bashkisë Mat” z. Shefqet Lata, me motivacionin “Për

merita të veçanta si pilot ushtarak dhe komandant njësie në aviacionin ushtarak shqiptar për rreth 30 vjet duke u bërë shqiptarja matjane e ajrit”.

Ceremonia u përshëndet nga Prefekti i Qarkut Dibër Nexhbedin Shehu dhe nga kryetari i shoqatës së Aviatorëve të Shqipërisë gjeneral brigade (R) Astrit Jaupi, i cili i dorëzoi z. Shefqet Lata “Certifikatën e Mirënjohjes” për kon-

tributin e veçantë në armën e aviacionit, si pilot i talentuar, kuadër i devotshëm dhe drejtues në vite i dy regjimenteve luftarakë.

Në emër të Komandës së Forcës Ajrore, fjalën përshëndetëse e mbajti nënkolonela Silvana Lahi, shefja e bashkëpunimit civilo-ushtarak. Ajo transmetoi urimet e Komandantit të Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli



Pulaj duke theksuar se: “Shefqet Lata i dashuruar me ëndrrën për të kapur qiejt, pasi mbaroi Akademinë e Aviacionit dhe viteve të para të fluturimit në Bazën Ajrore Kuçovë, përzgjidhet dhe dërgohet me studime jashtë vendit për

t’u bërë pjesë e një plejade pilotësh të aftë të drejtonin avionët luftarakë, ku ka treguar aftësi të jashtëzakonshme profesionale dhe karakterin e një piloti të veçantë dhe të guximshëm. Si drejtues dhe komandant i dy ish-regjimenteve të aviacionit në Gjadër dhe Rinas, ai ka treguar jo vetëm aftësi drejtuese por edhe marrëdhënie të shkëlqyera me vartësit, të reflektuara këto në respekt, komunikim dhe mbështetje, vlera kaq të domosdoshme për një liderशिp të suksesshëm. Marrja e titullit “Qytetar nderi i Bashkisë Mat” i një ish-anëtari të komunitetit të Forcave Ajrore nuk është vetëm respekti që i bëhet sot Shefqetit por është një kënaqësi dhe krenari që Forcat Ajrore kanë pasur në gjirin e tyre pilotë dhe drejtues kaq të vlerësuar dhe të respektuar si Shefqet Lata”.

Ceremonia u mbyll me kujtime dhe përshëndetjet e rastit nga shokët kolegët e ish-pilotit Lata dhe me një foto të përbashkët me të gjithë të pranishmit.

SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE,  
ANJEZA MUSOLLARI

Lidershipi nuk është aq shumë teknikë dhe metodë, sa është të hapësh zemrën. Lidershipi është frymëzim, për veten dhe të tjerët. Lidershipi i suksesshëm është për përjetimet njerëzore, jo proceset. Lidershipi nuk është një formulë apo program, por një aktivitet njerëzor që vjen nga zemra dhe merr parasysh zemrën e të tjerëve. Është një qëndrim, jo rutinë.

Në jetojmë në një epokë ku fjalët mund të kafshojnë, ku retorika zëvendëson arsyen. Gjykime të konsiderueshme çojnë në presionin e një reagimi të shpejtë. Gjykimet morale shpesh marrin shpjegime të shkurtra në diskutimet tona publike. Liderët paraqesin faktorin më të rëndësishëm të zhvillimit të shoqërisë. Nga iniciativa dhe aktiviteti i tyre varet zhvillimi i ekonomisë dhe i shoqërisë së një vendi.

Mënyra e sjelljes së liderëve ndaj vartësve për arritjen e objektivave të përcaktuara, apo siç quhet ndryshe stili i lidershipit ndërmarrës, varion nga njëri lider tek tjetri, si dhe në varësi të stilit të përdorur për arritjen e qëllimeve apo objektivave afatgjatë. Ajo çka i karakterizon të gjithë liderët është diskursi i tyre, duke i bërë ata përgjithësisht unikë dhe të veçantë për nga stili, temat e trajtuara, intonacioni dhe gjestikulacioni. Shumë nga problemet në shoqëri sot janë pjesërisht rezultat i lidershipit të papërgatitur për t'u përballur me kompleksitetin e realitetit të sotëm. Idetë moderne të lidershipit zakonisht bazohen mbi modele ushtarake ose mbi modele të mëparshme politike. Zakonisht aftësitë e një lideri kërkojnë në kohët kur ka vështirësi ose kur qëllimet ndryshojnë ose thelohen. Nga iniciativa e tyre varet suksesi i shoqërisë, pasi lidershipi duhet të reflektojë dhe prezantojë cilësitë më të mira drejtuese në arritjen e suksesit nëpërmjet organizimit të një grupi njerëzish për të arritur qëllimin e përbashkët.

Rënia e Perdes së Hekurt, ashtu si në mbarë Europën Qendrore dhe Lindore, solli ndryshime thelbësore edhe në shoqërinë shqiptare. Edhe pse më vonë se në vendet e tjera të Lindjes, rënia e komunizmit solli një metamorfozë të gjithanshme në politikë e ekonomi, dhe jo vetëm. Tronditja në shoqërinë shqiptare nuk mund të linte pa prekur edhe themelet e sistemeve të vlerave, tek të cilët qenë bazuar një larmi marrëdhëniesh sociale e njerëzore që e panë veten të zbuluar në një sistem të ri, fare të panjohur.

Aftësitë e lidershipit janë mjetet, sjelljet dhe mundësitë që i nevojiten një personi në mënyrë që të jetë i suksesshëm në motivimin dhe udhëheqjen e të tjerëve.

Liderët e fortë i trajtojnë njerëzit ashtu si dëshirojnë të trajtohen, ata janë jashtëzakonisht etik dhe besojnë se ndershmëria, përpjekja dhe besueshmëria formojnë themelin e suksesit.

Lidershipi nuk është një gradë, një titull ose një vend, fjala “lead” vjen nga një fjalë e vjetër angleze që do të thotë “të shkosh” ose “të udhëzosh”, kjo është ajo me të cilën lidhet lidershipi: të shkosh në vende dhe të udhëzosh të tjerët (Kouzes).

Lidershipi ka shumë përkufizime, dy elementet që e përshkruajnë më së miri janë: përmbushja e misionit dhe ndikimi te njeriu.

Lidershipi ushtarak, është çelësi për çdo ushtri, ai e vë në qendër rolin e liderit ku e përshkruan si dikush që merr vendime për jetën dhe vdekjen, si përgjegjës për klimën dhe cilësinë e jetës së vartësve të tij. Lufta vendos të ardhmen e kombeve dhe popujve, nga lufta mund të varet jetesa madje edhe mbijetesa e kombeve, detyra e komandantit ushtarak është të sjellë fitoren pa pësuar nivele të larta të viktimave ose humbje të madhe të pasurisë. Diku rreth viteve 400 p.e.s., periudhë kjo në Kinë e njohur si lufta mes shteteve, ishte një gjeneral i njohur nga shteti i Ch'i i njohur si Sun Tzu, aftësia e tij për të fituar dhe zotësia e tij në luftë i dhanë atij popullaritet dhe fuqi. Lidershipi në luftë daton shumë herët.

**Sun Tzu**, një lider ushtarak, gjeneral i cili shkroi librin “Arti i Luftës” rreth mënyrës se si i kishte mposhtur kundërshtarët, e cila i shërbeu si shembull për teorinë ushtarake dhe gjeneralëve që erdhën më vonë. “Lideri Ushtarak është themeli i kombit (Giles), ai thekson se një lider ushtarak duhet të jetë edhe ekspert edhe inovator. Ai duhet të jetë i përgatitur mirë në parimet e lashta, por të ndërtohet mbi to në mënyrë që të mos bëhet i parashikueshëm, përndryshe do të kapeni në të kaluarën”.

Liderët ushtarakë duhet të fitojnë të drejtën për të komanduar, duke kuptuar temën komplekse të luftës, jo thjesht t'u dorëzohet pozicioni i tyre bazuar në lidhjet familjare ose privilegjin. Lider-

Liderët paraqesin faktorin më të rëndësishëm të zhvillimit të shoqërisë. Nga iniciativa dhe aktiviteti i tyre varet zhvillimi i ekonomisë dhe i shoqërisë së një vendi. Mënyra e sjelljes së liderëve ndaj vartësve për arritjen e objektivave të përcaktuara, apo siç quhet ndryshe stili i lidershipit ndërmarrës, varion nga njëri lider tek tjetri, si dhe në varësi të stilit të përdorur për arritjen e qëllimeve apo objektivave afatgjatë.

# “Hapi i parë drejt ndryshimit të botës është të ndryshojmë vizionin tonë për botën dhe vendin tonë në të”



shipi përfshin realitetin personal të një personi në tjetrin, aftësinë e një komandanti për të përdorur personalitetin e tij për të ndikuar drejtpërdrejtë në vartësit e tij për të përmbushur një mision. Liderët kontribuojnë në efektivitetin ushtarak në mënyrë indirekte duke hartuar dhe krijuar grupin, kushtet organizative dhe mjedisore që rrisin performancën individuale dhe kolektive, të tilla si një kulturë dhe identitet profesional, programet dhe shërbimet e burimeve njerëzore që mbështesin anëtarët dhe sigurojnë trajtimin e tyre. Sot ndryshimi i shpejtë teknologjik dhe shoqëror ka krijuar një rol mjaft të ndërlikuar të lidershipit për ushtarin profesional, përderisa sot një ushtar i ri është një njeri luftarak aq efektiv sa ka mundur ta prodhojë vendi ynë, ai është më sfidues për të udhëhequr për dy arsye: kompleksiteti i aftësive që duhet të mësohen për të kryer detyrat e tij dhe vlerat dhe qëndrimet e tij të ndryshueshme, të sjella nga shpejtësia me të cilin ndryshimi shoqëror ka ndodhur në 15-20 vitet e kaluara.

Lidershipi ushtarak, në krahasim me format e tjera të lidershipit, mund të konsiderohet që është i varur nga situata.

Akademia Ushtarake Amerikane shpjegon se betimi i një oficeri mban përgjegjësi morale, një oficer duhet vazhdimisht të vendosë standardet më të larta të sjelljes morale. Ata e vendosin oficerin si “njeriu i vjetër” që duhet të përkujdeset për problemet e detajuara personale të njerëzve të tij nën situatat e lodhshme. Këto përgjegjësi sipas tyre janë shumë më të mëdha se sa situatat e lidershipit në industri, biznes, ose lidershipit qytetar.

**Lider me cilësi të jashtëzakonshme luftarake dhe drejtuese, Hannibal Barca, i njohur si elefanti me mjekër**

Hannibal ishte një nga gjeneralët më të mëdhenj antik që ka jetuar së bashku me Cezarin, Pirron, Scipio Africanus, Demetrius Poliorcetes dhe Aleksandrin. Hannibal njihet për teknikën “lëvizja kthyesë duke anashkaluar” të cilën e përdori ndaj ushtresë romake duke i prerë rrugët furnizuese, që i çoi deri në tërheqje romakët. Fundi i tij erdhi pasi romakët kuptuan strategjinë e tij “refuzimi i betejës” dhe e lanë të bredhë në Itali derisa ushtria e tij u tërhoq në Kartagjenë, ku edhe u mund përfundimisht në betejën e Zanës nga Scipio.

**Arthur Wellesley**

Duke luftuar pothuajse gjatë gjithë kohës nëpër Indi, Spanjë, Francë dhe Belgjikë për 16 vjet, Wellington nuk u mposht asnjëherë në asnjë betejë të madhe dhe nuk e humbi kurrë asnjë fushatë. Ai shpesh akuzohet se ka thënë që ushtarët e tij ishin “Ilumi i tokës”, por citimi nuk është dhënë kurrë plotësisht: “Ushtarët tanë rekrutohen nga llumrat e tokës, është vërtet e mrekullueshme që ata janë bërë këta që janë”.

**John Churchill Marlborough**

U bë pjesë e jetës ushtarake, duke u bashkuar me Gardën e parë si një Ensign dhe duke udhëtuar në Afrikën e Veriut për tre vjet. Duke korrur shumë fitore veçmas, arritjet më të mëdha të Eugene dhe Marlborough ishin betejat e Blenheim, Malplaquet dhe Oudenarde në të cilat së bashku ata, si shumë gjeneralë të tjerë

në këtë listë, goditën francezët, duke ndihmuar kështu Aleancën e Madhe të fitojë Luftën e Sukcesit spanjoll.

**Frederiku II i Prusisë (1712-1786)**

Frederiku “i Madh” i Prusisë ishte padyshim më i miri nga të gjithë. Ai lejoi që të gjitha fetë të praktikoheshin lirshëm. Në të njëjtën kohë, ai e ktheu vëmendjen e tij te lufta dhe e provoi veten si një gjeni i teorisë ushtarake, në taktikë, strategji, lëvizje dhe furnizime.

**Aleksandri i Madh (356-323 p.e.s.)**

Aleksandri, kur ishte vetëm tridhjetë vjeç, shikoi në gjerësinë e sferës së tij, ai qau sepse nuk kishte më botë për të pushtuar. Ai e pushtoi të gjithë territorin midis Maqedonisë dhe Indisë, Aleksandri kapërceu dhe themeloi njëzet qytete të ndryshme në emrin e tij dhe ai vazhdoi për shekuj me radhë të nderohej si një Zot në shumë nga vendet që ai kishte pushtuar. Aleksandri hipi drejt fitores në krye të kalorësisë së tij dhe falangave të tij të majave në betejat të tilla si Hydaspes, Granicus, Issus dhe Guagamela. Gjeneraliteti i tij taktik është studiuar dhe studiohet edhe sot në akademitë ushtarake, mbi 2 300 vjet më vonë. Ai vdiq në moshën 33-vjeçare, përpara se shumë të tjerë në këtë listë të kishin fituar edhe fitoren e tyre të parë, jo i vrrarë nga armiku, por sepse ai piu një vazo të tërë (ndoshta të helmuar) të verës. Ai kurrë nuk ishte mundur.

**Jul Cezari**

Jul Cezari ishte komandanti i ushtresë Romake dhe një gjeni. Ai luajti një rol kyç në vdekjen e Republikës Romake dhe ngritjen e një Perandorie Romake. Ai nuk ishte vetëm i shpejtë dhe i zgjuar, por gjithashtu dinte të zhvillonte strategji dhe plane për ekspansionet e perandorisë dhe finesën e tij politike. Vendosmëria e tij, aftësitë e tij për të njohur kundërshtarët e bënë atë të fitojë një ndjekje të fuqishme. Ai në fund u vra nga shoku i tij Brutus.

**Franklin Rusvelt**

Franklin Rusvelt ishte një shtetas amerikan dhe lider politik i cili ndihmoi Amerikën gjatë viteve të tmerrshme të Depresionit të Madh. Rusvelt u afeksionua me politikën në moshën 29-vjeçare, ku dhe gjatë këtyre viteve ai ngeli i paralizuar në të dyja këmbët e tij. Por ai akoma nuk dëshironte të hiqte dorë nga politika deri kur u bë president në vitin 1993 dhe duhet theksuar që ai ishte i vetmi president deri më sot që e mbajti postin e tij me zgjedhje të lira për katër mandate deri në vitin 1945, kur ai vdiq.

Ai gjithashtu udhëhoqi ushtresinë amerikane dhe rriti superfuqitë e Amerikës. Njohuritë e tij politike, janë ato që çdo lider i vërtetë do të donte t'i kishte.

**Napoleon Bonaparte**

Napoleon Bonaparte ishte një lider i ushtresë franceze, i cili lulëzoi fuqishëm pas Revolucionit Francez i cili fshiu monarkinë. Ai ishte mendjemprehtë dhe dinak, gjithashtu ishte një person i cili dinte shumë dhe vërtetonte atë që ndonjëherë nuk është e nevojshme të kesh fuqi. Ushtritë e tij të vogla dinin të triumfonin

shumë mirë dhe mbi ushtritë e mëdha. Kodi I i Napoleonit për legalizimin e reformave që ai krijoi, akoma dhe sot janë ekzistente në shumë vende. Aftësitë e tij udhëheqëse ushtarake dhe lidhjet si burrë i zakonshëm e bënë atë kaq të famshëm dhe me influencë mbi Francën për shumë vite radhazi.

**George Washington**

Themeluesi i shteteve të Bashkuara të Amerikës, George Washington vazhdon të jetë akoma një prej liderëve më të mëdhenj që ne kemi parë ndonjëherë. Ai udhëhoqi Revolucionin Amerikan dhe më vonë udhëhoqi gjithë Amerikën në vitet e para të pavarësisë së saj, duke u bërë presidenti i parë i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ai ishte vizionar dhe kishte vizione pafund që të udhëhiqte Amerikën e ta bënte një superfuqi siç është sot. Këmbëngulja e tij, vendosmëria dhe aftësitë e tij për të marrë vendime gjatë kohërave të vështira e bënë atë një lider të madh dhe idhull për shumë njerëz që duan sukses.

**Abraham Lincoln**

Abraham Lincoln, presidenti i 16-të i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, udhëhoqi vendin gjatë Luftës Civile. Ai bëri përpjekje të fuqishme dhe bëri më të mirën që t'i mbante njerëzit të bashkuar gjatë kësaj periudhe. Amerika do të kishte qenë një vend shumë i vogël në vend të këtij vendi të madh. Ai mban emrin e Shpalljes së Emancipimit, në këtë mënyrë edhe fundin e skllavëritimit në SHBA. Bindjet e tij, përlësia, oratoria e bënë atë një nga udhëheqësit më të suksesshëm në histori.

**Martin Luther King**

Gjithçka filloi me një ëndërr, si gjithmonë ndodh. Një ëndërr për ndryshim dhe një ëndërr për një të nesërme më të mirë. Martin Luther King ishte një aktivist dhe një lider i të drejtave civile në SHBA. Ai gjithashtu luftoi për barazinë mes racave dhe u tregoi njerëzve figurën e një të ardhmeje më të mirë ku të gjithë njerëzit janë të barabartë. Guximi dhe dëshira për të luftuar për të drejtat deri në fund e bëjnë atë një lider të mirë. Ai fitoi dhe çmimin Nobel për Paqe në vitin 1964.

**Nelson Mandela**

Nelson Mandela ishte i pari President i Afrikës së Jugut i zgjedhur me zgjedhje demokratike. Ai ishte lideri dhe fytyra e lëvizjes Anti-Apartheid përgjatë gjithë jetës së tij, ai ishte luftëtar i pamëshirshëm ndaj diskriminimit racor. Për aksionet e tij ai u fut për një kohë të gjatë në burg, por prapë kjo nuk e uli ashpërsinë e tij. Ai doli jashtë si një hero dhe udhëhoqi vendin e lirë, me barazi. Ai luftoi për të drejtat e njerëzve me ngjyrë.

**Mahatma Gandhi**

Lindur si një djalë i zakonshëm, Mohandas Karamchand Gandhi, më vonë u njoh si babai i kombit apo “bapu”. Mahatma Gandhi qe në krye të Indisë kundër ligjeve tirane të britanikëve. Ai besonte në të vërtetën dhe vetëm e vërteta do të mbizotëronte dhe mbi të gjitha pa lënduar shpirtin, ai arriti të sillte lirinë në Indi. Lëvizjet mos bindëse civile, bojkotimet

ndaj të huajve etj., shfaqën rezistencën e tij ndaj britanikëve. Si përfundim britanikët e lanë Indinë dhe Gandhi u bë fytyra e kombit. Ai është një nga udhëheqësit më të mirë që ka ecur mbi këtë tokë.

**Filozofia politike**

Që të kuptosh filozofinë e procesit politik shqiptar, në asnjë moment nuk duhet lejuar që të harrohet edhe historia e ndikimit të mendimit politik të rilindësve shqiptarë, idetë dhe frymëzimi i të cilëve formësuari parimet, vlerat dhe orientimin perëndimor të politikës moderne shqiptare të njëqindvjeçarit që lamë pas. Rrjedhimisht, mendimi politik i rilindësve shqiptarë paraqet njëkohësisht një nxitje, por dhe sfidë intelektuale për studimin e politikës së re shqiptare dhe zhvillimin e mëtejshëm të mendimit politik që nga periudha antike e deri më sot. Ky mendim ndikon dukshëm në formimin e politikës moderne shqiptare, por edhe të politikave të mëhershme shqiptare.

Sami Frashëri në veprën e tij të traktatit politik mbi çështjen shqiptare, të titulluar “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’dotë bëhet”, i cili u bë manifest i Rilindjes Kombëtare Shqiptare, sintetizoi programin e lëvizjes, strategjinë dhe taktikën e saj. Në të u shprehën ideat demokratike të zhvillimit politik e shoqëror të vendit, të zhvillimit të arsimit, të kulturës e të shkencës. Ky mendim politik njëkohësisht ndikon qoftë me aktivitete të drejtpërdrejta, qoftë si formë frymëzimi edhe në formësimin e politikave dhe institucioneve të shumë kombeve të tjerë gjatë shekujve të kaluar, ashtu sikurse sot që shumë shqiptarë me aktivitetet e mendimet e tyre i dhurojnë civilizimit bashkëkohor idetë dhe kontributin e tyre në përpilimin e strategjive, doktrinave e politikave publike në nivel botëror. Materia e studimit të saj është bota shoqërore, ose thënë me fjalë të tjera natyra njerëzore dhe vlerat njerëzore.

Përpjekjet e vazhdueshme për një liri kuptimplotë dhe gatishmëri të vazhdueshme për bashkëpunim me kombet me fat të njëjtë të përvuajtur e liridashës kanë bërë që në fokus të filozofisë politike shqiptare të gjendet pikërisht natyra njerëzore dhe vlerat njerëzore. Si vazhdim i një tradite të tillë të udhëheqjes nga një filozofi humaniste, politika moderne shqiptare që nga pavarësia e Shqipërisë e këtej, ndryshe nga shumë popuj të tjerë të Ballkanit, në asnjë moment nuk përpilon e as nuk përdoret me platforma destruktive, as me doktrina të ekspansionit me çmim ndaj humanes. Sepse procesi politik shqiptar zhvillohet gjithë kohën në frymën e filozofisë së tij humaniste dhe mendimit të sendimentuar politik të rilindësve shqiptarë, pavarësisht fazave dhe vështirësive të periudhave të ndryshme. Ato janë premissat e filozofisë politike shqiptare dhe vlerat e procesit politik shqiptar. Dhe ato nuk zhbëhen e nuk ndryshohen lehtë, meqë thjesht është logjika që e formëson politikën moderne shqiptare.

Një nga mburrjet shekullore të politikave shqiptare është pozicionimi i mirëfilltë gjeostrategjik i shqiptarëve dhe orientimi i qëndrueshëm kah aleancat strategjike dhe miqësore, kah Perëndimi. Nuk ka arsye që kjo çështje të ndryshojë as në të ardhmen, por përkundrazi sikurse çdo dekadë të shkuar edhe në dekadat e ardhshme të shekullit të ri shqiptar, gatishmëria për partneritet politik pritet që të shënojë rritje në vazhdimësi pa luhatje dhe që kjo vlerë e orientimit politik të shqiptarëve të vazhdojë të jetë një nga përmasat kyç të kulturës politike shqiptare të shekullit të ri. Politikat inovative të së ardhmes pritet që të stimulojnë bashkëpunimin ndërkombëtar, politikat shqiptare me projekte konkrete e jo vetëm me fjalë.

“Duhet guxim që të ngrihesh dhe të flasësh, por po guxim duhet të ulesh dhe të dëgjosh”, Winston Churchill, ky është lideri që i duhet botës sot.

MSC. MIMOZA GOLIKJA

BRUKSEL, 15-16 QERSHOR 2022 - TAKIMI I MINISTRAVE TË MBROJTJES TË NATO-S

# "Lufta e Rusisë shkon përtej Ukrainës"

## Stoltenberg: Do sigurohemi të parandalojmë çdo sulm nga çdo fushë

Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s u takuan në Bruksel më 15 dhe 16 qershor 2022 për të trajtuar forcimin e NATO-s dhe mbështetjen më tej të vendeve partnere. Takimit të ministrave iu bashkua mbrëmjen e 15 qershorit ministri i Mbrojtjes i Ukrainës, Oleksii Reznikov për t'i përditësuar aleatët për atë që Ukraina ka sot nevojë urgjente.

Aleatët dhe partnerët i kanë ofruar Ukrainës pajisje ushtarake me vlerë miliarda dollarë, si dhe ndihmë ekonomike dhe humanitare. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg tha se Aleatët janë të përkushtuar të vazhdojnë të ofrojnë pajisjet ushtarake që Ukrainës i duhen për të triumfuuar, përfshirë armët e rënda dhe sistemet me rreze të gjatë. Z. Stoltenberg tha se ai priste që aleatët të bien dakord për një paketë ndihme gjithëpërfshirëse për Ukrainën në Samitin e Madridit. Kjo do ta ndihmonte Ukrainën për një afat më të gjatë, për të kaluar nga pajisjet e epokës sovjetike në pajisjet moderne të NATO-s dhe për të përmirësuar ndërveprimin me NATO-n. Ministrave aleatë iu bashkuan gjithashtu për diskutimet e tyre edhe ministrat e Mbrojtjes nga Gjeorgjia, Suedia, Finlanda dhe Bashkimi Europian.

Ministrat e Mbrojtjes të NATO-s trajtuan gjithashtu nevojën për të forcuar ndjeshëm parandalimin dhe mbrojtjen e Aleancës. Në përgjigje të pushtimit rus të Ukrainës, numri i grupeve luftarake të NATO-s është dyfishuar në tetë dhe më shumë se 40 000 trupa janë tani nën komandën e drejtpërdrejtë të NATO-s. Z. Stoltenberg tha se: "Tani do të marrim vendime për shkallën dhe dizajnin e qëndrimit tonë për një afat më të gjatë. Për të siguruar që ne mund të mbrojmë çdo centimetër të territorit aleat. Që në momentin e parë, në çdo kohë dhe kundër çdo kërcënimi. Kjo do të thotë rritje të mëdha në praninë, aftësitë dhe gatishmërinë tonë." Ai tha se kjo do të nënkuptonte më shumë formacione luftarake të vendosura përpara, të NATO-s, për të forcuar grupet e betejës në Lindje, më shumë mbrojtje ajrore, detare dhe kibernetike, pajisje të para-pozicionuara dhe rezerva armësh. Ai theksoi gjithashtu një model të ri force, me më shumë forca në gatishmëri më të lartë dhe forca specifike të paracaktuara për mbrojtjen e aleatëve të veçantë.

Sekretari i Përgjithshëm tha se Grupi i Kontaktit për Mbështetjen e Ukrainës i udhëhequr nga SHBA, diskutoi nevojat urgjente të Ukrainës për pajisje ushtarake dhe falënderoi Shtetet e Bashkuara për udhëheqjen dhe koordinimin e saj.

**Më shumë formacione luftarake, një model i ri force**

Në konferencën për shtyp që Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg dha përpara takimeve të ministrave të Mbrojtjes të NATO-s tha se: "pas dy javësh, ne do të takohemi në Madrid, të gjithë liderët e NATO-s, në një moment kyç për sigurinë tonë. Lufta e Rusisë kundër Ukrainës po përbën kërcënimin më të madh për sigurinë euroatlantike në dekada. Rusia tani është e përfshirë në një luftë brutale rrërimi kundër popullit ukrainas, duke shkakuar vdekje dhe shkatërrim në shkallë të gjerë, me pasoja të gjera dhe implikime globale, siç tregohet nga krizat e ushqimit dhe energjisë, të



orkestruara qëllimisht nga Rusia. Në këtë botë më të rrezikshme, ne duhet ta bëjmë NATO-n më të fortë dhe të mbështesim më tej partnerët tanë, -tha ai, -dhe kjo është ajo që ne do të bëjmë në takimin e kësaj jave të ministrave të Mbrojtjes."

Duke theksuar rëndësinë e takimit me ministrat e Ukrainës, Gjeorgjisë, Suedisë, Finlandës dhe Bashkimit Europian në mbrëmjen e datës 15 ai tha se: "kjo do të jetë një mundësi për ministrin e Mbrojtjes Reznikov që të na informojë për atë që Ukrainës i nevojitet urgjentisht, por dhe për mundësinë e mirë që aleatët e NATO-s të bëjnë njoftime të reja për mbështetjen e Ukrainës".

"Aleatët janë të përkushtuar të vazhdojnë të ofrojnë pajisjet ushtarake që Ukraina ka nevojë për të triumfuuar, duke përfshirë armët e rënda dhe sistemet me rreze të gjatë", -tha Stoltenberg. "Ne do të diskutojmë gjithashtu se si të shtojmë mbështetjen praktike për partnerët e tjerë në rrezik, përfshirë Bosnje Hercegovinën dhe Gjeorgjinë", -tha ai, duke specifikuar zonat e tjera të rrezikut. Duke qëndruar tek lufta në Ukrainë ai tha se: "aleatët dhe partnerët i kanë ofruar Ukrainës pajisje ushtarake me vlerë miliarda dollarë, si dhe ndihmë ekonomike dhe humanitare". Jens Stoltenberg tha se priste që në Samit, aleatët e NATO-s të bien dakord për një paketë ndihme gjithëpërfshirëse për

Ukrainën. "Duke ndihmuar Ukrainën për një afat më të gjatë, kalimi nga pajisjet e epokës sovjetike në pajisjet moderne të NATO-s, për të përmirësuar ndërveprimin me NATO-n."

"Aleatët kanë treguar vendosmërinë dhe janë të palëkundur në mbështetjen e tyre për sovranitetin dhe integritetin territorial të partnerëve tanë të ngushtë në Europë dhe për të drejtën e çdo kombi për të zgjedhur rrugën e tij, pa ndërhyrje nga jashtë. Vendimet e Finlandës dhe Suedisë për të aplikuar për anëtarësim në NATO janë historike", -tha Sekretari i Përgjithshëm. "Tani jemi duke punuar aktivisht në hapat e ardhshëm në procesin e anëtarësimit dhe ndërsa bëjmë këtë, ne marrim parasysh shqetësimet e sigurisë të të gjithë aleatëve", -dhe shtoi se ministrat e Mbrojtjes të NATO-s do të trajtojnë nevojën për të forcuar ndjeshëm parandalimin dhe mbrojtjen tonë për t'iu përgjigjur një realiteti të ri të sigurisë.

"Tashmë kemi bërë shumë, me shpejtësi dhe unitet. Në përgjigje të pushtimit rus të Ukrainës, ne kemi dyfishuar numrin e grupeve luftarake të NATO-s në tetë, dhe i zgjeruam ato nga Baltiku në Detin e Zi. Vendosëm mbi 40 000 trupa nën komandën e drejtpërdrejtë të NATO-s, kryesisht në krahun lindor, mbështetur nga fuqia e madhe ajrore dhe detare, dhe rritëm gatishmërinë dhe ushtrimet tona. Tani do të marrim vendime për shkallën

dhe modelin e qëndrimit tonë për një afat më të gjatë. Për të siguruar që ne mund të mbrojmë çdo centimetër të territorit aleat. Që në momentin e parë, në të gjitha kohët, dhe kundër çdo kërcënimi". Lidhur me këtë Stoltenberg theksoi se: "kjo do të thotë më shumë prani, më shumë aftësi dhe gatishmëri më të lartë, me më shumë formacione luftarake të vendosura përpara NATO-s për të forcuar grupet tona të betejës në Lindje. Më shumë mbrojtje ajrore, detare dhe kibernetike, pajisje të para-pozicionuara dhe rezerva armësh, një model i ri force, me më shumë forca në gatishmëri më të lartë dhe forca specifike të paracaktuara për mbrojtjen e aleatëve të veçantë", -tha ai.

**Investimi i mëtejshëm në mbrojtje, trendi i duhur**

Sekretari i Përgjithshëm tha se mirëpriste synimin e Gjermanisë për të forcuar angazhimin e saj në Lituani, "ku ajo drejton grupin tonë të betejës së NATO-s dhe zhvillon atë drejt një brigade më të fuqishme luftarake". Aleatët e tjerë po konsiderojnë gjithashtu se "çfarë mund të bëjnë më shumë", -tha ai. "Vendimet tona do ta bëjnë NATO-n më të fortë dhe sigurohemi që ne mund të parandalojmë çdo sulm në të gjitha fushat. Mbrojtjet më të forta në një botë më të rrezikshme kërkojnë më shumë

investime dhe më shumë investime së bashku. Që nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë nga Rusia, në vitin 2014, ne kemi parë shtatë vite radhazi rritje të investimeve të mbrojtjes në të gjithë aleatët europianë dhe Kanadaja". Aleatët po investojnë gjithashtu më shumë në aftësitë moderne dhe po kontribuojnë në vendosjet dhe stërvitjet e NATO-s. "Ky është trendi i duhur, -tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, -por që duhet të vazhdojë për një afat më të gjatë, për t'u përballur me sfidat e së sotmes dhe së nesërme". Ai shtoi në mbyllje se Grupi i Kontaktit për Mbështetjen e Ukrainës, udhëhequr nga SHBA, do të diskutonte Nevojat urgjente të Ukrainës për pajisje ushtarake dhe falënderoi Shtetet e Bashkuara për udhëheqjen dhe koordinimin e tyre.

**Aleatët e NATO-s janë të përkushtuar të vazhdojnë t'i ofrojnë Ukrainës pajisje ushtarake**

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg mori pjesë në takimin e Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës të udhëhequr nga SHBA në selinë e NATO-s, më 15 qershor 2022, për të diskutuar nevojat urgjente të Ukrainës për pajisje ushtarake. Sekretari i Përgjithshëm falënderoi Shtetet e Bashkuara për udhëheqjen e tyre dhe koordinimin dhe mirëpriti njoftimet e reja nga aleatët e NATO-s për mbështetjen ndaj Ukrainës. Ai theksoi se aleatët e NATO-s janë të përkushtuar të vazhdojnë t'i ofrojnë Ukrainës pajisjet ushtarake që i nevojiten për të triumfuuar, përfshirë armët e rënda dhe sisteme me rreze të gjatë. "NATO si një organizatë po rrit gjithashtu mbështetjen e saj", -tha ai, duke vënë në dukje se aleatët do të bien dakord për një paketë të re gjithëpërfshirëse të ndihmës për Ukrainën në Samitin e Madridit. Kjo do ta ndihmojë Ukrainën në një afat më të gjatë që të kalojë nga epoka sovjetike në pajisjet moderne të NATO-s dhe të përmirësojë ndërveprimin me NATO-n. Ky ishte takimi i tretë i Grupit të Kontaktit të Mbrojtjes së Ukrainës për të koordinuar ndihmën për Ukrainën. Rreth 45 vende, përfshirë Ukrainën, morën pjesë në këtë takim, zhvilluar përpara takimeve të ministrave të Mbrojtjes të NATO-s.



## Gjashtë aleatë eksplorojnë zgjidhje inovative për helikopterët e tyre të ardhshëm

Në margjinat e takimit të ministrave të mbrojtjes së NATO-s, më 16 qershor, ministrat e Francës, Gjermanisë, Greqisë, Italisë, Holandës dhe Mbretërisë së Bashkuar dedikuan 26.7 milionë euro për të gjitha shoqëritë e tjera të flotës së tyre të helikopterëve në Kapacitetin "Rotorcraft" të Gjeneratës së ardhshme të NATO-s (NGRC). Në bashkëpunim me industrinë, pjesëmarrësit do të fillojnë nga një fletë e pastër për të eksploruar se si t'i përshtatin nevojat e tyre me teknologjinë më të fundit në treg, duke parë opsione të tilla si shtytja hibride dhe elektrike, një arkitekturë sistematike e sistemit të hapur dhe ofrimi i pajisjeve të përmirësuara rrënjësisht. karakteristikat e fluturimit. "Ky është një shembull i qartë i NATO-s dhe Aleatëve që punojnë së bashku për të shfrytëzuar teknologjinë me ndryshim të shpejtë për të mirën e aftësive tona ushtarake. Duke investuar burimet tona dhe duke e kanalizuar zhvillimin tonë përmes një



kornize shumëkombëshe, ne po sigurohemi që aleatët të pajisen me pajisjet më të mira në dispozicion", -theksoi zëvendëssekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoană. Helikopterët me shumë role të mesme kanë një gamë të gjerë përdorimesh civile dhe ushtarake, duke përfshirë transportin e njerëzve dhe pajisjeve, evakuimin mjekësor, kërkimin-shpëtimin. Shumë prej këtij lloji që operohen aktualisht nga aleatët do të arrijnë fundin e ciklit të tyre jetësor në vitet në vijim. Faza e Konceptit NGRC do të sigurojë themelin për aleatët që të zhvillojnë dhe nxjerrin brezin e ardhshëm të tyre. Agjencia e NATO-s për Mbështetjen dhe Prokurimin (NSPA) do të ekzekutojë Fazën e Konceptit në emër të pjesëmarrësve. NGRC përbën një nga projektet shumëkombëshe të NATO-s me dukshmëri të lartë dhe demonstroi angazhimin e Aleatëve të NATO-s për të ruajtur një avantazh teknologjik dhe për të ndjekur bashkëpunimin shumëkombësh.

STOLTENBERG PRET SEKRETARIN AMERIKAN TË MBROJTJES NË TAKIMIN E MINISTRAVE TË MBROJTJES TË NATO-S

# NATO është e përgatitur për një afat të gjatë, në mbështetjen për Ukrainën

**S**ekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg mirëpriti Sekretarin Amerikan të Mbrojtjes Lloyd Austin në selinë e NATO-s, më 16 qershor 2022, përpara takimeve të ministrave të mbrojtjes aleate, të ditës së dytë. Stoltenberg falënderoi Sekretarin Austin për udhëheqjen e Shteteve të Bashkuara në forcimin e NATO-s dhe për angazhimin e tij personal ndaj Aleancës. Stoltenberg mirëpriti gjithashtu mbështetjen e fortë të SHBA-së për Ukrainën, duke përfshirë njoftimin e saj të ri për ndihmë shtesë, dhe përgëzoi Sekretarin Austin për rolin e tij në mbledhjen e Grupit të Kontaktit të Mbështetjes së Ukrainës, duke siguruar që vendi të vazhdojë të marrë furnizime jetike ushtarake. “E mirëpres shumë njoftimin e djeshëm të Presidentit të Shteteve të Bashkuara për të rritur më tej mbështetjen për Ukrainën, sepse ata vërtet kanë nevojë për mbështetjen tonë”, -tha Stoltenberg. “Ishte një mesazh i fortë nga të gjithë aleatët dhe partnerët e NATO-s se ne jemi të përgatitur për një kohë të gjatë. Aleatët e NATO-s janë të përgatitur të vazhdojnë të



ofrojnë mbështetje thelbësore dhe të paprecedentë për Ukrainën. Jemi në këtë takim ministror të ministrave të Mbrojtjes të NATO-s, duke u përgatitur për Samitin e fundit të këtij muaji në Madrid. Ky do të jetë

një samit transformues në një moment kyç për sigurinë tonë. Ne do të marrim vendime të rëndësishme se si të forcojmë më tej parandalimin dhe mbrojtjen tonë në një botë më të rrezikshme”.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I NATO-S VIZITON HOLANDËN

## Takimi i shtatë aleatëve të NATO-s për përgatitjen e Samitit të Madridit

**S**ekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg u bashkua me krerët e shtatë vendeve aleate të NATO-s në Hagë, më 14 qershor 2022, për të ndihmuar në përgatitjen e Samitit të Aleancës në Madrid. Takimi u organizua nga kryeministri holandez Mark Rutte dhe kryeministrja daneze Mette Frederiksen, me pjesëmarrjen e presidentit rumun Klaus Iohannis, kryeministrit belg Alexander de Croo, kryeministrit polak Mateusz Morawiecki, kryeministrit portugez António Costa dhe kryeministrit letonez Krišjānis Karinš.

Sekretari i Përgjithshëm tha se Samiti i ardhshëm do të ishte historik dhe transformues, përfshirë vendimet për mbështetje të fortë për Ukrainën në afat të shkurtër dhe afatgjatë. Ai gjithashtu nënvizoi se: “aleatët do të bien dakord për një forcim të madh të qëndrimit tonë, i cili do të kërkojë prezencë më të fuqishme dhe të gatshme luftarake, gatishmëri edhe më të lartë dhe më shumë pajisje dhe furnizime të para-pozicionuara dhe përsëritet që gjithnjë e më shumë aleatë po lëvizin për të shpenzuar të paktën 2 për qind të PBB-së për mbrojtjen”. Lidhur me Konceptin Strategjik për të cilin do të bihet dakord në Madrid, Stoltenberg tha se: “dokumenti do të vlerësojë mjedisin tonë të ndryshuar të sigurisë dhe do të riafirmojë vlerat dhe detyrat tona themelore; do të jetë një plan për të ardhmen e Aleancës”. Të pranishmit diskutuan gjithashtu aplikimet historike të Finlandës dhe Suedisë për t'u bashkuar me NATO-n. “Unë mirëpres hapat seriozë të ndërmarrë tashmë për të adresuar shqetësimet e Turqisë”, -tha Sekretari i Përgjithshëm, duke shtuar se “Dialogu ynë vazhdon, për të gjetur një rrugë të bashkuar përpara”.



## Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në Finlandë: Anëtarësimi i Finlandës dhe Suedisë në NATO do të forconte më tej rajonin nordik të Aleancës

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, në një agjendë takimesh, ishte në Finlandë, ku mori pjesë në bisedimet “Kultaranta 2022”, zhvilluar në 12-13 qershor në rezidencën verore presidenciale. Ai u takua me Presidentin, Sauli Niinistö, ministrin e Punëve të Jashtme, z. Pekka Haavisto dhe zyrtarë të tjerë të lartë finlandezë.

Në takim me Presidentin Niinistö, Sekretari i Përgjithshëm theksoi se anëtarësimi i Finlandës dhe Suedisë në NATO do të forconte më tej rajonin nordik të Aleancës. “Aleatët po shqyrtojnë hapat e ardhshëm në rrugën tuaj drejt NATO-s. Ne duhet të trajtojmë shqetësimet e sigurisë të të gjithë aleatëve, përfshirë shqetësimet turke për grupin terrorist PKK”, -nënvizoi z. Stoltenberg. “Kështu që unë mbetem në kontakt të ngushtë me ju, Sauli, dhe kolegët tuaj, me Suedinë dhe me aleatin tonë Turkiye në rrugën përpara. Stafii im gjithashtu mbetet në dialog të ngushtë me zyrtarët nga të tre vendet, për të adresuar shqetësimet legjitime turke dhe për të ecur përpara në pranimin tuaj në Aleancën tonë”, -tha ai.

Z. Stoltenberg theksoi se siguria e Finlandës dhe Suedisë ka rëndësi për NATO-n dhe se NATO mbetet vigjilente, me prani të shtuar në rajon dhe më shumë stërvitje. Ai përmendi stërvitjen BALTOPS, e cila aktualisht po zhvillohet me pjesëmarrjen e mbi 7000 forcave nga 14 aleatë të NATO-s, si dhe nga Finlanda dhe Suedia. Forcat finlandeze dhe suedeze po marrin pjesë gjithashtu në stërvitjen e integruar të mbrojtjes ajrore dhe raketore të NATO-s në të gjithë rajonin Baltik dhe Poloni. “Këto janë demonstrime të fuqishme të përkushtimit të NATO-s ndaj këtij rajoni me rëndësi strat-

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s:

### Çështjet e sigurisë së Suedisë dhe Finlandës kanë rëndësi për NATO-n

**S**ekretari i Përgjithshëm i NATO-s Jens Stoltenberg, riafirmoi angazhimin e aleatëve për sigurinë suedeze dhe finlandeze gjatë vizitës në Suedi, më 13 qershor 2022. Duke folur në konferencën për shtyp me kryeministren Magdalena Andersson, z. Stoltenberg nënvizoi se siguria e Suedisë dhe Finlandës kanë rëndësi për NATO-n.

Sekretari i Përgjithshëm u prit në rezidencën e Kryeministrit në Harpsund dhe zhvilloi bisedime me kryeministren Andersson, ministrin e Punëve të Jashtme Ann Linde dhe ministrin e Mbrojtjes, Peter Hulqvist. Ai u takua gjithashtu me të gjithë qeverinë suedeze. Gjatë bisedimeve, Sekretari i Përgjithshëm dhe homologët e tij suedeze diskutuan mjedisin e ndryshuar rrënjësishëm të sigurisë që rezultojnë nga lufta e paligjshme e Rusisë kundër Ukrainës dhe ranë dakord për nevojën për të mbështetur më tej Ukrainën.

Z. Stoltenberg përsëriti vendimet e Suedisë dhe Finlandës për të aplikuar për anëtarësim në NATO, duke e përshkruar këtë si: “një hap historik në një kohë kritike për sigurinë tonë”. Ai tha se anëtarësimi i Suedisë dhe Finlandës në Aleancë do të lehtësonte bashkëpunimin më të ngushtë të mbrojtjes nordike dhe baltike, do të forconte praninë e NATO-s në Veriun e Lartë dhe do të rriste sigurinë transatlantike në përgjithësi.



Sekretari i Përgjithshëm tha se ai dhe stafi i tij mbeten në kontakt të ngushtë me të gjitha palët për të adresuar shqetësimet legjitime të Turqisë në lidhje me grupin terrorist PKK dhe për të bërë përpunim sa më shpejt të jetë e mundur në aplikimet për anëtarësim të Suedisë dhe Finlandës. Ai përsëriti gatishmërinë e qeverisë suedeze për të adresuar shqetësimet e Turqisë, duke vënë në dukje ndryshimet në kuadrin legjislativ të Suedisë për kundër-terrorizmin dhe punën për të siguruar që korniza ligjore e Suedisë për eksportin e armëve do të pasqyrojë statusin e tyre të ardhshëm si anëtarë të NATO-s, me angazhime të reja ndaj aleatëve.

Z. Stoltenberg kujtoi se që nga aplikimi i saj, Suedia ka marrë garanci sigurie nga shumë vende të NATO-s dhe Aleanca ka rritur praninë dhe stërvitjet e saj në rajon. Suedia aktualisht po pret BALTOPS 2022, stërvitjen më të madhe të NATO-s në Detin Baltik, e cila përfshin mbi 7000 forca nga 14 aleatë dhe partnerë, përfshirë Suedinë dhe Finlandën. Të dy vendet po marrin pjesë në stërvitjen e integruar të mbrojtjes ajrore dhe raketore të NATO-s në të gjithë rajonin Baltik dhe Poloni.

egjike”, -theksoi Stoltenberg.

Sekretari i Përgjithshëm foli në ditën e hapjes së Bisedimeve Kultaranta, me temë “Veriu i fortë, i qëndrueshëm dhe i përgjegjshëm”, së bashku me Presidentin Niinistö dhe kryeministrin norvegjez Jonas Gahr Støre. Z. Stoltenberg diskutoi mjedisin sfidues të sigurisë, me “luftën mizore të Rusisë kundër një fqinji paqësor”. Ai paralajmëroi se Ambiciei e Putinit shkojnë përtej Ukrainës. Të ashtuquajturat ‘traktate sigurie’ që ai i paraqiti NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara dhjetorin e kaluar shtruan kërkesa jo vetëm ndaj Ukrainës, por edhe ndaj NATO-s. Këto kërkesa përbëjnë rishkrimin e plotë të urdhrat evropian të sigurisë, të parashikuar në Aktin Final të Helsinkit. Një nga parimet kryesore të Aktit Final është e drejta e çdo kombi për të zgjedhur rrugën e tij”.

“Kërkesat e Finlandës dhe Suedisë për t'u bashkuar me Aleancën tonë dërgojnë një mesazh të qartë. Agresioni nuk paguan. Frikësimi nuk funksionon. Dera e NATO-s mbetet e hapur”, -tha Sekretari i Përgjithshëm.


Bisedimet Kultaranta ofrojnë një forum publik vjetor ku diskutohen ngjarjet aktuale politike, ndërsa tema e këtij viti, “Rajoni nordik i përgjegjshëm, i fortë dhe i qëndrueshëm”, ishte i fokusuar në politikën e jashtme dhe të sigurisë, ku kishte rreth 100 pjesëmarrës nga sfera të ndryshme. Pjesëmarrësit përfshinin vendimmarrës politikë, studiues dhe përfaqësues të qeverisë, industrisë, OJF-ve dhe medias. Bisedimet Kultaranta nuk janë zhvilluar në Naantali për dy vjet. Në vitin 2020, diskutimet u mbajtën në studiot Yle në Helsinki dhe vitin e kaluar u anuluan për shkak të pandemisë.

# Zjarret në pyje: Komisioni European vendos flotën e tij zjarrfikëse për sezonin 2022

Që nga sot, flota e avionëve zjarrfikës të BE-së do të jetë funksionale për të ndihmuar vendet europiane të luftojnë zjarret në pyje gjatë gjithë sezonit të pikut. Flota është pjesë e “rescEU”, një rezervë europiane e burimeve që u përgjigjet emergjencave. Të pozicionuar në Kroaci, Francë, Greqi, Itali, Spanjë dhe Suedi, 12 aeroplanë zjarrfikës dhe 1 helikopter zjarrfikës do të jenë gati për t’u vendosur këtë verë kur zjarret kërkojnë një përgjigje të përbashkët europiane për të shpëtuar jetë, mjete jetese dhe mjedis.

Komisioneri për Menaxhimin e Krizave Janez Lenarčič tha: “Vitin e kaluar ne dëshmuam sezonin e dytë më të keq të zjarreve në pyje në BE-në. Kjo shërbeu si një kujtesë e dhimbshme e efektit shkatërrues që zjarret pyjore kanë në jetën e europianëve. Që nga sot, e gjithë Flota “rescEU” e BE-së prej 13 avionësh zjarrfikës është funksionale për të siguruar një shtresë mbrojtjeje shtesë për jetët, mjetet e jetesës dhe mjedisin. Kjo nuk do të ishte e mundur pa bashkëpunimin e Kroacisë, Francës, Greqisë, Italisë, Spanjës dhe Suedisë, të cilët janë mikpritës të shuarjes së zjarrit me helikopterë dhe aeroplanë. Me këtë flotë në vend, BE-ja rrit gatishmërinë e kontinentit për t’u përballur me zjarret në pyje.”

Parashikimet shkencore për sezonin e këtij viti të zjarreve në pyje parashikojnë rrezeq mbi mesataren për Europën Qendrore dhe në të gjithë Mesdheun. Sidomos muajt e verës prirën të jenë më të ngrohtë dhe më të



thatë se vitet e mëparshme.

## Kapacitetet e shpëtimit të zjarrit në vitin 2022

Flota e zjarrfikësve “rescEU” 2022 përfshin 12 aeroplanë dhe 1 helikopter nga gjashtë shtete anëtare të BE-së, të gatshëm për t’u vendosur në çdo vend të BE-së në kohë nevojë.

Flota përbëhet nga: 2 avionë zjarrfikës nga Kroacia, 2 aeroplanë zjarrfikës nga Franca, 2 aeroplanë zjarrfikës dhe një helikopter nga Greqia, 2 aeroplanë zjarrfikës nga Italia, 2 aeroplanë zjarrfikës nga Spanja dhe 2 aeroplanë zjarrfikës nga Suedia.

Flota është e pozicionuar në mënyrë strat-

egjike në të gjithë shtetet anëtare të BE-së, të cilat operojnë dhe mirëmbajnë avionët. Përmes flotës së tij “rescEU” të financuar plotësisht nga BE, Komisioni European po rrit kapacitetin e reaguesve kombëtarë në të gjithë Europën. Kjo vjen si shtesë e më shumë se 200 zjarrfikësve dhe pajisjeve teknike nga Bullgaria,

Finlanda, Franca, Gjermania, Rumania dhe Norvegjia që do të pozicionohen në Greqi për të lejuar mbështetje të menjëhershme për reaguesit e parë kombëtarë gjatë gjithë sezonit të zjarreve.

BE-ja siguron një qasje të koordinuar për parandalimin, përgatitjen dhe reagimin ndaj zjarreve në pyje. Kur shkalla e një zjarri në pyll mposht aftësitë e reagimit të një vendi, ai mund të kërkojë ndihmë nëpërmjet Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së. Pasi të aktivizohet, Qendra e Koordinimit të Reagimit Emergjent të BE-së koordinon dhe financoi ndihmën e vënë në dispozicion nga Shtetet Anëtare të BE-së dhe gjashtë shtete të tjera pjesëmarrëse. Përveç kësaj, BE-ja ka krijuar Rezervën Europiane të Mbrojtjes Civile për të pasur një numër kritik të kapaciteteve të disponueshme të mbrojtjes civile që mundësojnë një përgjigje kolektive më të fortë dhe koherente. Nëse urgjenca kërkon më shumë ndihmë për shpëtimin e jetëve, Komisioni aktivizon flotën e tij të zjarrfikësve “rescEU” për t’u përballur me fatkeqësitë në Europë. Shërbimi i hartës satelitore emergjente “Copernicus” i BE-së plotëson operacionet me informacion të detajuar nga hapësira.

# HERA siguron vaksina për vendet anëtare të BE-së në përgjigje të shpërthimeve të lisë së majmunëve

HERA, Autoriteti i Gatishmërisë dhe Reagimit Shëndetësor i Komisionit European, ka lidhur një kontratë me kompaninë “Bavarian Nordic” për blerjen e 109 090 dozave të vaksinave të tyre të gjeneratës së tretë në përgjigje të shpërthimeve aktuale të lisë së majmunëve. Ndërsa numri i rasteve vazhdon të rritet, kjo marrëveshje do t’i bëjë vaksinat të disponueshme shpejt për të gjitha vendet anëtare të BE-së, Norvegjinë dhe Islandën. Agjencia Ekzekutive e Komisionit për Shëndetin dhe Dixhitalin (HaDEA) bleu vaksinën e gjeneratës së tretë për llogari të Autoritetit Shëndetësor të Përgatitjes dhe Reagimit ndaj Emergjencave (HERA). Më pas, HERA do t’i vërë vaksinat në dispozicion të Shteteve Anëtare të BE-së në mënyrë proporcionale, duke filluar nga ata që kanë më shumë nevojë. Kjo është hera e parë që buxheti i BE-së është përdorur për programin “EU4Health” për blerjen e drejtpërdrejtë të vaksinave për shtetet anëtare. Bazuar në numrin më të madh të rasteve, dërgesat do të fillojnë tashmë në fund të muajit për vendet anëtare prioritare, të cilat kanë dhënë përjashtime kombëtare për vaksinën. Që nga 18 maji, rreth 900 raste të lisë së majmunëve janë raportuar në 19 shtete anëtare të BE-së dhe në Norvegji dhe Islandë. HERA është një shtyllë kryesore e Bashkimit European të Shëndetësisë dhe një aset themelor për forcimin e reagimit dhe gatishmërisë së BE-së ndaj emergjencave shëndetësore. Në vlerësimin e saj të rrezikut,



Qendra Europiane për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (ECDC) këshilloi vendet e prekura që të marrin në konsideratë vaksinimin e hershëm pas ekspozimit për të parandaluar sëmundjen ose për ta bërë rrjedhën e saj më pak të rëndë.

Nënkryetari për promovimin e mënyrës sonë europiane të jetesës, Margaritis Schinas, tha: “Sigurimi i vaksinave me shpejtësi dhe me efikasitet për të gjitha shtetet anëtare të BE-së në përgjigje të shpërthimeve të lisë së majmunëve është detyra jonë morale dhe një rezultat konkret i kapacitetit tonë të prekshëm për të mbrojtur njerëzit. Ne

nuk do të kursejmë asnjë përpjekje në ndërtimin e një Unioni të vërtetë të fortë të Shëndetësisë Europiane në shërbim të qytetarëve tanë. Kjo është arsyeja pse për herë të parë po përdorim buxhetin e BE-së, përmes programit EU4Health, për të blerë direkt vaksina për shtetet anëtare. Gatishmëria dhe reagimi efikas ndaj kërcënimeve shëndetësore në zhvillim është qëllimi ynë i përbashkët.”

Komisionerja për Shëndetin dhe Sigurinë Ushqimore, Stella Kyriakides, shtoi: “Për herë të parë, ne i blejmë këto vaksina me programin EU4Health dhe ua dhurojmë



shteteve tona anëtare. Shpërthimi i lisë së majmunëve ka treguar rëndësinë e një qasjeje të bashkuar të BE-së për gatishmërinë dhe reagimin ndaj kërcënimeve shëndetësore në zhvillim. Me marrëveshjen e nënshkruar sot, ne sigurojmë që Shtetet Anëtare do të kenë akses në vaksinat shumë të nevojshme për të mbrojtur njerëzit e ekspozuar ndaj lisë së majmunëve. Ky është një demonstrim i prekshëm i kapacitetit tonë të përforcuar për t’u përgjigjur me shpejtësi krizave shëndetësore, por edhe reagimi i shpejtë dhe kolektiv që mund të japë një Union European Shëndetësor.

## Certifikata Dixhitale Europiane për COVID-in: Komisioni European miraton marrëveshjen politike për zgjatjen njëvjeçare



Komisioni European mirëpret marrëveshjen e përkohshme politike të arritur nga Parlamenti European dhe Këshilli për zgjatjen njëvjeçare të certifikatës dixhitale të BE-së për COVID-in, pas propozimit të Komisionit. Kjo zgjatje do t’i lejojë njerëzit të vazhdojnë të përdorin certifikatën e tyre, e cila fillimisht duhej të skadonte më 30 qershor 2022, për të udhëtuar në të gjithë BE-në.

Krahas zgjatjes, bashkëligjvënësit ranë dakord edhe për:

-Një detyrim për Komisionin për të paraqitur një raport të detajuar deri më 31 dhjetor 2022. Ky raport mund të shoqërohet me propozime legjislativë për të lejuar një vlerësim të ri të nevojës për të shfuqizuar ose mbajtur certifikatën, në varësi të zhvillimeve në situatën shëndetësore;

-Sqarimin se certifikatat e vaksinimit duhet të pasqyrojnë të gjitha dozat e administruara, pavarësisht nga shteti anëtar ku njerëzit kanë marrë vaksinimin e tyre;

-Mundësinë për të lëshuar një certifikatë rikuperimi pas një testi antigjen;

-Zgjerimin e gamës së testeve të autorizuara të antigjenit të përdorura për t’u kualifikuar për një certifikatë COVID-19;

-Mundësinë për të lejuar lëshimin e certi-

fikatave të vaksinimit për personat që marrin pjesë në provat klinike.

Didier Reynders, Komisioneri për Drejtësinë, tha: “Që nga fillimi i pandemisë COVID-19, situata ka evoluar vazhdimisht, ashtu si edhe mjetet tona. Me mbi 1.8 miliardë certifikata të lëshuara, dy gjëra janë të qarta: situata epidemiologjike mund të ndryshojë me shpejtësi dhe certifikata dixhitale e BE-së për COVID-in ka qenë një mjet jetik për të na ndihmuar të përballemi me situatën në zhvillim. Ne jemi të vendosur të rivendosim lëvizjen e lirë të pakufizuar dhe mirëpresim vendimin e disa shteteve anëtare për të hequr të gjitha kufizimet e udhëtimit, duke përfshirë paraqitjen e një certifikate COVID. Marrëveshja e sotme do të na ndihmojë të vazhdojmë të lehtësojmë udhëtimin e lirë dhe të sigurt nëse infeksionet në rritje i detyrojnë shtetet anëtare të rifusin përkohësisht kufizime”. Parlamenti European dhe Këshilli do të duhet të miratojnë zyrtarisht marrëveshjen politike të arritur dhe deri më 31 dhjetor 2022, Komisioni do të publikojë një raport mbi certifikatën dixhitale të BE-së për COVID-in, i cili mund të shoqërohet me një propozim për të shkurtuar periudhën e zbatimit të rregullores, duke marrë parasysh evoluimin e situatës epidemiologjike.



## Super-kompjuteri i ri european është inauguruar në Finlandë

Në një ngjarje të dedikuar, Ndërmarrja e Përbashkët Europiane e Kompjuterëve me Performancë të Lartë inauguron super-kompjuterin e saj më të ri: LUMI, me vendndodhje në Kajaani, Finlandë. LUMI është super-kompjuteri më i shpejtë dhe më efikas me energji në Europë, i renditur gjithashtu i treti më i shpejtë në botë. Është një përpjekje e përbashkët e Ndërmarrjes së Përbashkët “EuroHPC” dhe një konsorciumi prej dhjetë vendeve europiane: Finlanda, Belgjika, Çekia, Danimarka, Estonia, Islanda, Norvegjia, Polonia, Suedia dhe Zvicra. Zëvendës-Presidentja Ekzekutive për një Europë të përshtatshme për Epokën Dixhitale, Margrethe Vestager tha: “Sot shënon një hap të madh për transformimin dixhital dhe të gjelbër të Europës. Lumi tani është super-kompjuteri më i shpejtë dhe më efikas në energji në Europë dhe një nga më të fuqishmit në botë.

Falë kapacitetit të tij masiv kompjuterik, Lumi do të mundësojë zbulime shkencore, për shembull në mjekësi dhe në kërkime klimatike me një ritëm shumë më të shpejtë. Mund të jetë në zhvillimin e vaksinave, diagnostikimin e kancerit ose zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike.

Ky është një shembull i shkëlqyer i potencialit të madh të inteligjencës artificiale për të përmirësuar jetën tonë.” LUMI është i pari nga super-kompjuterët e sipërmarrjes së përbashkët “EuroHPC” që do të dalë në treg. Ai do të ketë një performancë maksimale prej 550 petaflops (550 milionë miliardë llogaritje në sekondë) ndërsa do të fuqizohet plotësisht nga energjia e rinovueshme: LUMI përdor sisteme natyrale të ftohjes dhe nxehtësia e tij e mbetur do të përbëjë rreth 20 përqind të ngrohjes qendrore në qytetin e Kajaanit, duke reduktuar ndjeshëm gjurmën vjetore të karbonit të gjithë qytetit. LUMI do të jetë përgjithësisht i aksesueshëm për përdoruesit europianë në shtator 2022 dhe do të kontribuojë në përsheptimin e krijimit të njohurive të reja dhe zgjidhjeve për sfidat globale të shoqërisë. Fuqia e tij kompjuterike do të plotësojë super-kompjuterët ekzistues të Ndërmarrjes së Përbashkët “EuroHPC”: “Discoverer” në Bullgari, “MeluXina” në Luksemburg, “Vega” në Slloveni dhe “Karolina” në Çeki. Tre super-kompjuterë të tjerë “EuroHPC” janë duke u zhvilluar: LEONARDO në Itali, “Deucalion” në Portugali dhe “MareNostrum 5” në Spanjë.

Pse u zgjodh Aushvici? Kjo është për shkak të tij, si vend i përshtatshëm... Së pari, ishte në kufirin ku mbaroi Rajhu i Tretë dhe filloi Polonia. Auschwitz ishte një nga qendrat kryesore tregtare me rrugë transporti të përshtatshme dhe funksionale. Nga ana tjetër, pylli i afërt ndihmoi për të fshehur krimet e kryera atje nga sytë kureshtarë.



Çfarë është kampi i përqendrimit të Aushvicit?

Është ende gjallë një brez që ka përjetuar tmerrret e nazizmit, urinë, shfarosjen masive dhe sa e thellë mund të jetë rënia morale. Bazuar në dokumentet e ruajtura dhe dëshmitë e dëshmitarëve që e dinë vetë se çfarë janë kampet e përqendrimit të Luftës së Madhe Patriotike, historianët modernë paraqesin një pamje të asaj që ndodhi, e cila, natyrisht, nuk mund të jetë shteruese. Duket e pamundur të numërosh numrin e viktimave të makinës skëterrë të nazizmit për shkak të shkatërrimit të dokumenteve nga SS, dhe thjesht mungesës së raporteve të detajuara për të vdekurit dhe të vrarët.

Kompleksi i ndërtesave për mbajtjen e robërve të luftës, u ndërtua nën kujdesin e SS me urdhër të Hitlerit në vitin 1939. Kampi i përqendrimit të Aushvicit ndodhet afër Krakovit. 90% e atyre që përmbaheshin në të ishin hebrenj etnikë. Pjesa tjetër, robër lufte sovjetike, polakë, ciganë dhe përfaqësues të kombësive të tjera, të cilët në numrin e përgjithshëm të të vrarëve dhe të torturuarve arriti në rreth 200 mijë.

Emri i plotë i kampit të përqendrimit është Aushvic Birkenau. Auschwitz është një emër polak, zakonisht përdoret në territorin e ish-Bashkimit Sovjetik.

Historia e kampit të përqendrimit. Mirëmbajtja e robërve të luftës

Edhe pse kampi i përqendrimit Aushvic është i njohur për shkatërrimin në masë. Popullsia hebreje, fillimisht u konceptua nga konsiderata paksa të ndryshme.

Pse u zgjodh Aushvici? Kjo është për shkak të tij, si vend i përshtatshëm... Së pari, ishte në kufirin ku mbaroi Rajhu i Tretë dhe filloi Polonia. Auschwitz ishte një nga qendrat kryesore tregtare me rrugë transporti të përshtatshme dhe funksionale. Nga ana tjetër, pylli i afërt ndihmoi për të fshehur krimet e kryera atje nga sytë kureshtarë.

Në vitin 1940, popullsia vendase që jetonte pranë kazermave u dëbua me forcë nga ushtria gjermane për ndërtimin e ndërtesave shtesë në territorin e liruar, ku më vonë kishte një krematorium dhe qeli. Në vitin 1942, kampi u rrethua me një gardh të fortë betoni të armuar dhe tela të tensionit të lartë.

Megjithatë, edhe masa të tilla nuk i ndaluan disa prej të burgosurve, megjithëse rastet e arratisjes ishin jashtëzakonisht të rralla. Ata që kishin mendime të tilla e dinin se në çdo përpjekje, të gjithë të burgosurit e tyre do të shkatërroheshin.

Në të njëjtin vit, 1942, në një konferencë të NSDAP, u mor një vendim për nevojën e shfarosjes masive të hebrenjve dhe “zgjidhjen përfundimtare të çështjes hebraike”. Në fillim, hebrenjtë gjermanë dhe polakë u internuan në Aushvic dhe kampe të tjera gjermane të përqendrimit të Luftës së Dytë Botërore. Pastaj Gjermania ra dakord me aleatët për të kryer një “spastrim” në territoret e tyre. Duhet përmendur se jo të gjithë u pajtuan lehtësisht me këtë. Për shembull, Danimarka ishte në gjendje t’i shpëtonte nënshtrësve të saj nga vdekja e sigurt. Kur qeveria u informua për “gujetinë” e planifikuar të SS, Danimarka organizoi një transferim të fshehtë të hebrenjve në një shtet neutral, Zvicër. Kështu u shpëtuan më shumë se 7 mijë jetë.

Megjithatë, në statistikën e përgjithshme të të vrarëve, të torturuarve nga uria, rrënjët, puna e shpinës, sëmundjet dhe përvojat çnjerëzore, 7000 njerëz janë një pikë në një det gjaku të derdhur. Gjatë ekzistencës së kampit, sipas vlerësimeve të ndryshme, u vranë nga 1 deri në 4 milionë njerëz.

Në mesin e vitit 1944, kur lufta e nisur nga gjermanët mori një kthesë të fortë, njerëzit SS u përpoqën të transportonin të burgosur nga Aushvici në perëndim, në kampe të tjera. Dokumentet dhe çdo dëshmi e masakrës së pamëshirshme u shkatërruan masivisht. Gjermanët shkatërruan krematoriumin dhe dhomat e gazit. Në fillim të vitit 1945, nazistët duhej të lironin shumicën e të burgosurve. Ata donin të shkatërronin ata që nuk mund të shpëtonin. Për fat të mirë, falë ofensivës ushtria sovjetike arriti të shpëtojë disa mijëra të burgosur, përfshirë fëmijë, mbi të cilët u kryen eksperimente.

**Struktura e kampit**  
Aushvici u nda në 3 komplekse kampesh të mëdha: Birkenau-Auschwitz, Monowitz dhe



Aushvic-1. Kampi i parë dhe Birkenau u bashkuan më vonë në një kompleks prej 20 ndërtesash, ndonjëherë disa kate.

Blloku i dhjetë ishte larg vendit të fundit për sa i përket kushteve të tmerrshme të paraburgimit. Këtu kryheshin eksperimente mjekësore, kryesisht te fëmijët. Si rregull, “eksperimente” të tilla nuk ishin aq me interes shkencor, sa ishin një metodë tjetër e bullizmit të sofistikuar. Veçanërisht mes ndërtesave binte në sy blloku i njëmbëdhjetë, që shkaktoi tmerr edhe te rojet vendase. Kishte një vend për tortura dhe ekzekutime, më të shkuajdesurit dërgoheshin këtu, të torturuar me mizori të pamëshirshme. Pikërisht këtu u bënë përpjekje për herë të parë për shfarosje masive dhe maksimalisht “efektive”. Mes dy bllqeve u ndërtua një mur ekzekutimi, ku sipas shkencëtarëve u vranë rreth 20 mijë njerëz.

Në vend u instaluan gjithashtu disa varje dhe inceneratorë. Më vonë u ndërtuan dhoma gazi, të afta të shkatërronin deri në 6 mijë njerëz në ditë.

Të burgosurit që vinin u caktuan nga mjekët gjermanë për ata që ishin të aftë për punë dhe ata që u dërguan menjëherë për vdekje në dhomën e gazit. Më shpesh, gratë e dobëta, fëmijët dhe të moshuarit konsideroheshin të paaftë.

Të mbijetuarit u mbajtën në kushte të ngushta, praktikisht pa ushqim. Disa prej tyre i tërhoqën zvarrë trupat e të vdekurve ose i prisnin flokët, të cilat shkonin në fabrikat e tekstilit. Nëse një i burgosur në një shërbim të tillë do të arrinte të qëndronte për disa javë, ata do ta hiqnin qafe dhe do të merrnin një të re. Disa ranë në kategorinë e “privilegjuar” dhe punuan për nazistët si rrobaqepës dhe berberë.

Hebrenjtë e dëbuar u lejuan të merrnin jo më shumë se 25 kg peshë nga shtëpia. Njerëzit morën me vete më të vlefshmen dhe më të rëndësishmen. Të gjitha gjërat dhe paratë e mbetura pas vdekjes së tyre u dërguan në Gjermani. Më parë ishte e nevojshme të çmontohej dhe të zgjidhej gjithçka e vlefshme që të burgosurit po bënin në të ashtuquajturën “Kanada”. Vendi e mori këtë emër për faktin se më parë “Kanada” quheshin dhuratat dhe dhuratat me vlerë të dërguara nga jashtë për polakët. Puna në “Kanada” ishte relativisht më e butë se në përgjithësi në Aushvic. Aty punonin gratë. Ndër gjërat mund të gjente ushqim, që në “Kanada” të burgosurit të mos vuanin aq shumë nga uria. Burrat SS nuk ngurruan të ngacmonin vajzat e bukura. Përdhunimi nuk ishte i pazakontë këtu.

Kampi i përqendrimit të Aushvicit (Aushvic, Poloni) ishte një qytet i vërtetë. Kishte gjithçka për jetën e ushtarakëve: mensa me ushqime të bollshme, kinema, teatër dhe të gjitha përfitimet njerëzore për nazistët. Ndërsa të burgosurit nuk merrnin as sasinë minimale të ushqimit (shumë vdiqën në javën e parë ose të dytë nga uria), ndërkohë që burrat SS po festonin pandërprerë, duke shijuar jetën.

Mjeku Josef Mengele

Pasi Josef Mengele u plagos në 1943, ai u konsiderua i papërshtatshëm për të vazhduar shërbimin e tij dhe u dërgua si mjek në Aushvic, kampi i vdekjes. Këtu ai pati mundësinë të realizonte të gjitha idetë dhe eksperimentet e tij, të cilat ishin sinqerisht të çmendura, mizore dhe të pakuptimta.

Autoritetet urdhëruan Mengele të kryente eksperimente të ndryshme, për shembull, në temën e efektit të të ftohtit ose lartësisë mbi një person. Pra, një eksperiment mbi efektin e temperaturës, Jozefi kreu, duke e mbuluar të burgosurin me akull nga të gjitha anët derisa ai vdiq nga hipotermia. Kështu, u bë e qartë se në cilën temperaturë të trupit ndodhin pasoja të pakthyeshme dhe vdekje.

Mengele pëlqente të eksperimentonte me fëmijët, veçanërisht me binjakët. Rezultatet e eksperimenteve të tij ishin vdekja e pothuajse 3 mijë të miturve. Ai iu nënshtrua operacioneve të detyruara të ndryshimit të seksit, transplantëve të organeve dhe procedurave të dhimbshme në përpjekje për të ndryshuar ngjyrën e syve të tij, gjë që përfundimisht çoi në verbëri. Kjo, sipas tij, ishte dëshmi e pamundësisë që “i papastërti” të bëhej një arian i vërtetë.

Në vitin 1945, Jozefi duhej të ikte. Ai shkatërroi të gjitha raportet e eksperimenteve të tij dhe, pasi kishte lëshuar dokumente të falsifikuara, iku në Argjentinë. Ai jetoi një jetë të qetë pa vështirësi dhe shtypje, duke mos u kapur dhe ndëshkuar kurrë.

Kur u shembën të burgosurit?

Në fillim të vitit 1945, situata në Gjermani ndryshoi. Trupat sovjetike filluan një ofensivë aktive. Burrat SS duhej të fillonin evakuimin, i cili më vonë u quajt “marshimi i vdekjes”. Gjashtëdhjetë mijë të burgosur u urdhëruan të ecnin drejt Perëndimit. Gjatë rrugës u vranë mijëra të burgosur. Të dobësuar nga uria dhe puna e padurueshme, të burgosurve iu desh të bënin më shumë se 50 kilometra. Të gjithë ata që mbetën prapa dhe nuk mund të shkonin më tutje u qëlluan menjëherë. Në Gliwice, ku arritën të burgosurit, ata u dërguan me vagonë mallrash në kampet e

përqendrimit të vendosura. Çlirimi i kampeve të përqendrimit u bë në fund të janarit, kur në Aushvic mbetën vetëm rreth 7 mijë të burgosur të sëmurë dhe në vdekje, të cilët nuk mund të largoheshin në Gjermani.

Numri i viktimave

Është e pamundur të përcaktohet numri i saktë i të vrarëve në Aushvic, pasi shumë dokumente u shkatërruan, përveç kësaj, gjermanët nuk mbajtën një regjistrim të viktimave të dërguara në dhomat e gazit menjëherë pas mbërritjes.

Që nga viti 1940, rreth 10 ngarkesa trenash kanë mbërritur çdo ditë në kampin e përqendrimit të Aushvicit nga territoret e pushtuara dhe Gjermania. Në skalion kishte 40-50 e ndonjëherë edhe më shumë vagonë. Çdo karrocë mbante nga 50 deri në 100 persona. Rreth ¼ e të gjithë atyre që u sollën u dërguan në dhomat e gazit brenda disa orësh. Kishte krematoriume të fuqishme për djegien e kufomave, përveç tyre, trupat u dogjën në sasi të mëdha në zjarre speciale. Sipas tyre gjerësia e brezit: Krematoriumi nr. 1 - 216 000 persona në 24 muaj; Krematoriumi nr.2 - në 19 muaj - 1 710 000 njerëz; Krematoriumi nr. 3 - mbi 18 muaj ekzistencë - 1 618 000 njerëz; Krematoriumi nr.4 - në 17 muaj - 765 000 njerëz; Krematoriumi nr 5 - 810 000 njerëz në 18 muaj.

Historianët modernë pajtohen se midis 1.1 dhe 1.6 milionë njerëz u vranë në Aushvic, shumica e të cilëve ishin hebrenj. Ky vlerësim është marrë në mënyrë indirekte, përmes studimit të listave për dëbim dhe studimit të të dhënave për mbërritjen e trenave në Aushvic.

Historiani francez Georges Weller ishte një nga të parët që përdori të dhënat për dëbimin në vitin 1983, dhe mbi bazën e tyre, ai vlerësoi numrin e të vrarëve në Aushvic në 1 613 000 njerëz, 1 440 000 prej të cilëve ishin hebrenj dhe 146 000 ishin polakë. Në këtë të fundit, që konsiderohet si vepra më autoritare e historianit polak Francisc Pieper sot, jepet vlerësimi i mëposhtëm:

- 1 100 000 hebrenj
  - 140 000-150 000 polakë
  - 100 000 rusë
  - 23 000 ciganë
- Përveç kësaj, një numër i paspecifikuar homoseksualësh u shfarosën në kamp.

Nga rreth 16 mijë robër lufte sovjetike të mbajtur në kamp, 96 njerëz mbijetuan.

Rudolf Goess, komandant i Aushvicit në vitet 1940-1943, në dëshminë e tij në Tribunalin e Nurembergut, vlerësoi numrin e të vdekurve në 2.5 milionë, megjithëse ai pretendoi se nuk e dinte numrin e saktë, pasi nuk mbante të dhëna. Kështu thotë ai në kujtimet e tij.

Eksperimentet mbi njerëzit

Eksperimentet mjekësore praktikoheshin gjerësisht në kamp. Studioheshin efektet e kimikateve në trupin e njeriut, testonin barnat më të fundit farmaceutike. Të burgosurit u infektuan artificialisht nga malaria, hepatiti dhe sëmundje të tjera të rrezikshme si eksperiment. Kastrimi i meshkujve dhe sterilizimi i femrave, veçanërisht femrave të reja, i shoqëruar me heqjen e vezoreve, ishin të zakonshme.

Ish-kancelarja Angela Merkel në një prej vizitave të saj në muzeun e Aushvic Birkenau do të shprehte indinjatën e saj për pjesën më të errët të historisë së vendit të saj: “Ndiheh thellësisht e turpëruar nga krimet barbare të kryera këtu nga gjermanët. Këto ishin krime që shkuan përtej asaj që mund të imagjinohet”. “Por, heshtja nuk është përgjigje”, -tha Merkel, duke nënvizuar gjithashtu nevojën për të kujtuar se gjermanët ishin fajtorë dhe se është e rëndësishme që autorët të identifikohen qartë.

Përshtati: ZENO JAHAJ

*“Pas meje qëndron një mur që rrethon sektorët e lirë të këtij qyteti, pjesë e një sistemi të gjerë pengesash që ndan të gjithë kontinentin e Europës. . . . Duke qëndruar para portës së Brandenburgut, çdo njeri është një gjerman, i ndarë nga njerëzit e tjerë. Çdo njeri është një berlinëz, i detyruar të shikojë një plagë. . . . Për sa kohë që kjo portë është e mbyllur, për sa kohë që kjo plagë e një muri lejohet të qëndrojë, nuk është vetëm çështja gjermane ajo që mbetet e hapur, por çështja e lirisë për të gjithë njerëzimin. . . . Sekretar i Përgjithshëm Gorbaçov, nëse kërkon paqe, nëse kërkon prosperitet për Bashkimin Sovjetik dhe Europën Lindore, nëse kërkon liberalizim, eja këtu te kjo portë.”*  
*Zoti Gorbaçov, hape këtë portë!*  
*Zoti Gorbaçov, prishe këtë mur!”*  
*(Nga fjala e Ronald Reagan, në Portën e Brandenburgut, 12 qershor 1987)*

Në prill të vitit 1987, kur më caktuan të shkruaj fjalimin, ishin duke u zhvilluar festimet për 750-vjetorin e themelimit të Berlinit tashmë. Mbretëresha Elizabeth e kishte vizituar tashmë qytetin. Mikhail Gorbachev do të pritej brenda pak ditësh. Edhe pse Presidenti nuk kishte planifikuar të vizitonte vetë Berlinin, ai do të ishte në Europë në fillim të qershorit, fillimisht për të vizituar Romën, më pas për të kaluar disa ditë në Venecia për një samit ekonomik. Me kërkesë të qeverisë së Gjermanisë Perëndimore, orari i tij u rregullua për t'i lejuar të ndalonte në Berlin për disa orë gjatë kthimit nga Italia për në Shtetet e Bashkuara.

Më thanë vetëm se Presidenti do të fliste në Murin e Berlinit, se ai kishte të ngjarë të tërhiqte një audiencë prej rreth 10 000 dhe se, duke pasur parasysh mjedisin, ai ndoshta duhet të fliste për politikën e jashtme.

Më vonë, atë muaj kalova një ditë e gjysmë në Berlin me ekipin e avancuar të Shtëpisë së Bardhë përpara ardhjes së Presidentit, ekspertë të logjistikës, agjentë të Shërbimit Sekret dhe zyrtarë të shtypit, të cilët shkonin në vendin e çdo vizite presidenciale për të bërë rregullimet përkatëse. Gjithçka që duhej të bëja në Berlin ishte të gjeja material për fjalën e Presidentit. Kur takova diplomatin e amerikan të rangut të lartë në Berlin, supozova se do të më jepte diçka.

Një burrë trup-shëndoshë dhe me syze të trasha, diplomati dukej i shqetësuar e i hutuar gjatë gjithë bisedës sonë, sikur vetë perspektiva e një vizite nga Ronald Reagan e bënte nervoz. U ndal në disa udhëzime të imta, por pothuajse të gjitha “çfarë nuk duhej”, pra, plot me ide për çka Presidenti nuk duhet të thoshte. Më informoi se, berlinezët perëndimorë, me prirje më të majta nga të gjithë gjermano-perëndimorët, ishin intelektualisht dhe politikisht të sofistikuar. Prandaj, Presidenti do të duhet të kishte kujdes. Asnjë goditje e gjoksit. Asnjë përplasje sovjetike. Dhe asnjë deklaratë nxitëse për Murin e Berlinit. Berlinezët perëndimorë, shpjegoi diplomati, ishin mësuar prej kohësh me strukturën që i rrethonte.

Pasi u ndava nga diplomati, disa anëtarëve të ekipit dhe mua na bënë një fluturim mbi qytet me një helikopter të ushtrisë amerikane. Edhe pse gjithçka që ka mbetur nga ai mur sot (2003) janë thjesht gurë shtrimi që tregojnë se ku qëndronte, në 1987 struktura që dominonte Berlinin. I ngritur në vitin 1961 për të frenuar rrjedhën e gjermano-lindorëve që kërkonin t'i shpëtonin sistemit komunist duke ikur në Berlinin Perëndimor, muri, 3.6 m i gjatë, rrethoi plotësisht Berlinin Perëndimor. Nga ajri, muri dukej se ndante dy mënyra të ndryshme të ekzistencës.

Në njërën anë të murit shtrihej lëvizja, ngjyra, arkitektura moderne, trotualet e mbushura me njerëz, trafiku. Nga ana tjetër shtrihej një lloj zbrazëtie. Ndërtesat shfaqnin ende shenja nga granatimet gjatë luftës. Makinat dukeshin të pakta dhe të

rrënuara, këmbësorët të veshur keq. Kur helikopteri qëndroi pezull mbi Burgun Spandau, strukturën e rrëmujshme me tulla në të cilën Rudolf Hess ishte ende i burgosur, ushtarët me pushkë mbi supe në postet e rojeve të Gjermanisë Lindore përtej burgut, na ngulën sytë nga dylbitë. Vetë muri, i cili nga Berlini Perëndimor ishte dukur një strukturë e thjeshtë betoni, ana e Berlinit Lindor e veshur me poste roje, vrapime qensh dhe rresht pas rreshti me tela me gjemba u shfaq nga ajri si një kompleks i ndërlikuar. Piloti na tërhoqi vëmendjen te gropat e zhavorrit të gërmuar. Nëse një roje gjermano-lindore do të linte dikë t'i kalonte për t'u arratisur në Berlinin Perëndimor, na tha piloti, roja do të detyrohej t'i shpjegonte gjurmët komandantit të tij.

Atë mbrëmje, u shkëputa nga ekipi i avancuar për t'u bashkuar me një duzinë berlinezë për darkë. Mikpritësit tanë ishin Dieter dhe Ingeborg Elz, të cilët ishin tërhequr në Berlin pasi Dieter përfundoi karrierën e tij në Bankën Botërore në Uashington, D.C. Edhe pse nuk ishim takuar kurrë, kishim miq të përbashkët dhe Elz ishte ofruar për të organizuar këtë darkë për të dhënë një ndjenjë për qytetin e tyre. Ata kishin ftuar berlinezë të sferave të ndryshme të jetës dhe pikëpamjeve politike - biznesmenë, akademikë, studentë, shtëpiakë.

Ne biseduam për një kohë për motin, verën gjermane dhe koston e banimit në Berlin. Më pas tregova atë që më tha diplomati, duke shpjeguar se pas fluturimit tim mbi qytet atë pasdite e kisha të vështirë ta besoja. “A është e vërtetë?” - e pyeta. “A jeni mësuar me murin?”

Elz dhe të ftuarit e tyre i hodhën sytë njëri-tjetrit të shqetësuar. Mendova se e kisha dëshmuar veten si një amerikan i pacipë dhe pa takt në atë masë sa diplomati kishte frikë se edhe Presidenti mund të dukej i tillë. Pastaj një burrë ngriti dorën dhe tregoi me gisht. “Motra ime jeton njëzet milje në atë drejtim”, -tha ai. “Unë nuk e kam parë atë për më shumë se dy dekada. Mendon se mund të mësohem me këtë?”, -foli edhe një tjetër. “Çdo mëngjes në rrugën e tij për në punë - shpjegoi ai, -kalaja pranë një kulle roje. Çdo mëngjes, një ushtar më shikonte me dylbi. Ai ushtar dhe unë flasim të njëjtën gjuhë. Ne ndajmë të njëjtën histori. Por njëri prej nesh është kujdestar i kopshtit zoologjik dhe tjetri është një kafshë, dhe kurrë nuk jam i sigurt se cila është cila”.

E zonja e shtëpisë shpërtheu. Një grua e hirshme, ajo papritmas ishte zemëruar. Fytyra e saj ishte skuqur. Bëri grusht njëren dorë dhe e goditi në pëllëmbën e tjetrës. “Nëse ky Gorbaçovi është serioz me fjalët e tij për glasnost dhe perestrojkën, -tha ajo, -ai mund ta provojë këtë. Ai mund ta heqë qafe këtë mur”.

Duke u kthyer në Shtëpinë e Bardhë, i thashë Tony Dolan, në atë kohë drejtor i shkrimit të fjalimeve presidenciale, se kisha ndërmend të përshtatja komentin e Ingeborg Elz, duke i bërë thirrje për të shembur Murin e Berlinit si pasazh qendror të fjalimit. Toni më mori me vete për te drejtori i komunikimit, Tom Griscom, për t'ia paraqitur atij idenë. “Të dy juve duhet të mendonit dhe të punonit shumë për të më penguar të them jo, -thotë Griscom, -por kur më treguat për udhëtimin, veçanërisht për çka keni mësuar nga disa gjermanë se sa shumë e urrenin murin, mendova me vete: “E dini, duke bërë thirrje që muri të shembet,

thjesht mund të funksionojë”.

Kur u ula të shkruaja, do të doja të isha në gjendje të them se e gjeta veten aq të frymëzuar sa fjalët thjesht më erdhën vetë. Por nuk ndodhi kështu. “Zoti Gorbaçov, prishe këtë mur!” As që mund ta kuptoja si duhet. Në një draft shkrova: “Zotëri Gorbaçov, rrëzoje këtë mur!”, duke përdorur fjalën “zotëri” sepse mendova disi se kjo do t'i pëlqente audiencës gjermane të Presidentit dhe do ta “rrëzonte” sepse ishte e vetmja folje që më erdhi në mendje. Në draftin tjetër kam ndërruar “rrëzoje” me “hiq”, duke shkruar: “Zotëri Gorbaçov, hiqe këtë mur”, sikur të ishte një lloj përmirësimi. Deri në fund të javës nuk kisha bërë asgjë tjetër veç një draft të parë, edhe pse e konsideroja banal. Unë ende mund të dëgjoja kërcitjet e çizmeve kauboj të Tony Dolan-it ndërsa ai ecte nëpër korridor nga zyra e tij në timen për ta hedhur atë draft mbi tavolinën time.

“Nuk është mirë”, -tha Toni.  
“Çfarë nuk shkon me të?”, -e pyeta.  
“Sapo të thashë. Nuk është mirë.”

Javën në vijim punova një draft të pranueshëm. Kishte nevojë për përpunim, pjesa për reduktimin e armëve, për shembull, duhej ende të plotësohej, por ai përcaktoi elementët kryesorë të fjalimit, duke përfshirë sfidën për të shembur murin. Të premten, më 15 maj, fjalimet për udhëtimin e Presidentit në Romë, Venecia dhe Berlin, përfshirë draftin tim, u përcollën Presidentit dhe të hënën, më 18 maj, fjalim-shkruesit iu bashkuan Presidentit në Zyrën Ovale. Fjalimi im ishte i fundit që diskutuam. Tom Griscom i kërkoi Presidentit komentet e tij mbi draftin tim. Presidenti u përgjigj thjesht se i pëlqente.

“Zoti President, - i thashë, - në udhëtimin paraprak mësova se fjalimi juaj do të dëgjohet jo vetëm në Berlinin Perëndimor, por në të gjithë Gjermaninë Lindore. Në varësi të kushteve të motit, shpjegova, radiot do të ishin në gjendje ta çonin fjalimin deri në lindje, Moskën vetë. A ka ndonjë gjë që dëshironi t'u thoni njerëzve në anën tjetër të Murit të Berlinit?”

Presidenti përkuli kokën dhe mendoi. “Epo, -u përgjigj ai, -është ai pasazhi për shembjen e murit. Ai mur duhet të bjerë”. Kjo është ajo që do të doja t'u them atyre”. Kalova disa ditë duke u përpjekur të përmirësoja të folurit. Unë supozoj se duhet të pranoj se në një moment e kam nxjerrë në të vërtetë “Z. Gorbaçov, shemb këtë mur”, duke e zëvendësuar me sfidën, në gjermanisht, për të hapur Portën e Brandenburgut, “Zotëri Gorbaçov, machen Sie dieses Tor auf” (Hape këtë portë).

“Përse e bëre atë?”, -pyeti Toni.  
“Do të thotë që nuk e kupton?” -iu përgjigja. “Meqenëse audienca do të jetë gjermane, Presidenti duhet t'i thotë në gjermanisht idetë e mëdha.”

“Piter, -tha Toni, duke tundur kokën, -kur jeni duke shkruar për Presidentin e Shteteve të Bashkuara, jepini atij në anglisht idenë e tij të madhe”. Toni futi përsëri shprehjen dhe idenë siç ishte: “Z. Gorbaçov, shembe këtë mur”.

Tre javë para mbajtjes së tij, fjalimi iu shpërnda Departamentit të Shtetit dhe Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Të dy u përpoqën ta shuanin atë. Ndihmës sekretari i shtetit për çështjet e Europës Lindore e sfidoi fjalimin me telefon. Një anëtar i lartë i stafit të Këshillit të Sigurisë Kom-

bëtare protestoi kundër fjalimit. Diplomati i rangut amerikan në Berlin e kundërshtoi fjalimin me kabllo. Drafti ishte naiv. Do të krijonte shpresa të rreme. Ishte i patakt. Ishte provokues pa nevojë. Departamenti i Shtetit (Ministria e Punëve të Jashtme) dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare dorëzuan draftet e tyre alternative, në ditarin tim shënohet se nuk ishin më pak se shtatë, duke përfshirë një të tillë, shkruar nga diplomati në Berlin. Në secilën prej tyre mungonte thirrja për të shembur murin.

Në parim, Departamenti i Shtetit dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare nuk kishin asnjë kundërshtim ndaj thirrjes për shkatërrimin e murit. Drafti i paraqitur nga diplomati në Berlin, për shembull, përmbante rreshtin: “Një ditë, ky mur i shëmtuar do të zhduket”. Nëse linja e diplomatit ishte e pranueshme, fillimisht pyesja veten, çfarë nuk shkonte me timen? Pastaj pashë edhe një herë linjën e diplomatit. “Një ditë?” Një ditë edhe luani do të shtrihej me qengjin, por ju nuk do të donit të mbanit frymën. “Ky mur i shëmtuar do të zhduket?” Çfarë do të thoshte kjo? Se muri do të ngrihej dhe do të rrëzohej vetë? Muri do të zhdukej vetëm kur sovjetikët ta rrëzonin ose të linin dikë tjetër ta rrëzonte për ta, por “ky mur i shëmtuar do të zhduket” e injoroi fare çështjen e veprimit njerëzor. Ajo që Departamenti i Shtetit dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare po thoshin, në fakt, ishte se Presidenti mund të vazhdonte dhe të bënte një thirrje për shkatërrimin e murit, por vetëm nëse ai përdorte një gjuhë kaq të paqartë dhe eufemiste, sa të gjithë mund ta kuptonin menjëherë se në fakt ai nuk do të thoshte atë.

Javën që Presidenti u nis për në Europë, Tom Griscom filloi të më thërriste në zyrën e tij sa herë që Departamenti i Shtetit dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare parashtronin një kundërshtim të ri. Çdo herë, Griscom më kërkoi t'i tregoja atij pse besoja se Departamenti i Shtetit dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare ishin gabim dhe se fjalimi, siç e kisha shkruar unë, ishte i drejtë. Kur arrita në zyrën e Griscom në një rast, gjeta Colin Powell, në atë kohë Zëvendës Këshilltar për Sigurinë Kombëtare, duke më pritur. Unë isha një 30-vjeçar që nuk kisha pasur kurrë një punë me kohë të plotë jashtë shkrimit të fjalimeve. Powell ishte një gjeneral karriere. Pasi dëgjova Powell-in të recitonte të gjitha argumentet kundër fjalimit në mënyrën e tij të mësuar me forcë, megjithatë, dëgjova veten duke recituar të gjitha argumentet në favor të fjalimit në një mënyrë po aq të fuqishme. Mezi mund ta besoja tonin tim të zërit. Powell dukej ca i befusuar dhe i tërhequr.

Disa ditë përpara se Presidenti të nisej për në Europë, Tom Griscom mori një telefonatë nga shefi i shtabit, Howard Baker, duke i kërkuar Griscom të shkonte në zyrën e tij. Unë hyra brenda dhe ishin senatori Baker (Baker kishte shërbyer në Senat përpara se të bëhej Shef i Stafit) dhe Sekretari i Departamentit të Shtetit, vetëm ata të dy. Sekretari i Departamentit të Shtetit George Shultz e kundërshtoi fjalimin. Ai tha: “Unë me të vërtetë mendoj se linja për shembjen e murit do të jetë një fytyrë për zotin Gorbaçov”, -kujton Griscom. “I thashë atij se fjalimi duhet të kishte një shenjë në këtë pjesë. ‘Zoti Sekretar’, -i thashë, -Presidenti ka komentuar për këtë linjë-ide të veçantë dhe ai është i kënaqur me të. Dhe mund t'ju premtoj se kjo linjë do të ketë jehonë”. Sekretari

i Shtetit qartësisht nuk ishte i lumtur, por e pranoi. Mendoj se kjo e mbylli temën. Nuk ndodhi kështu.

Kur grupi udhëtues arriti në Itali (unë mbeta në Uashington), Sekretari i Departamentit të Shtetit e kundërshtoi fjalimin edhe një herë, këtë herë Zëvendëshefit të Kabinetit Kenneth Duberstein. “Shultz mendoi se linja ishte shumë e ashpër ndaj Gorbaçovit”, -thotë Duberstein. Më 5 qershor, Duberstein e uli Presidentin në kopshtin e pasurisë ku ai po qëndronte, e informoi për kundërshtimet ndaj fjalimit, më pas i dha një kopje të fjalimit, duke i kërkuar që të rilexonte pasazhin qendror.

Reagan kërkoi këshillën e Duberstein. Duberstein u përgjigj se ai mendonte se linja për shembjen e murit dukej e mirë. “Por unë i thashë atij: Ti je President, kështu që duhet të vendosësh, dhe më pas, -kujton Duberstein, -ai, me atë buzëqeshjen e tij të mrekullueshme të njohur në fytyrën e tij, tha: “Le ta lëmë siç është””.

Ditën që Presidenti mbërriti në Berlin, shteti dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare paraqitën një draft tjetër alternativ. “Ata ishin ende kështu pikërisht në mëngjesin e fjalimit”, -thotë Tony Dolan. Nuk do ta harroj kurrë, megjithatë, në limuzinë në rrugën për në Murin e Berlinit, Presidenti i tha Duberstein se ishte i vendosur të jepte pikërisht linjën e diskutueshme dhe shtoi duke buzëqeshur: “Çunat në Departamentin e Shtetit do më vrasin, -tha ai, -por kjo është gjëja e duhur për të bërë.”

\*\*\*

Ekziston një shkollë mendimi sikur Ronald Reagan arriti të dukej mirë vetëm sepse kishte fjalim-shkrues të zgjuar që i vendosnin fjalët në gojë. Por Jimmy Carter, Walter Mondale, Bob Dole dhe Bill Clinton kishin të gjithë shkrimtarë të zgjuar.

**Pse kishte vetëm një Komunikues të Madh?**

Sepse fjalim-shkruesit e Ronald Reaganit nuk përpiqeshin kurrë të fabrikonin imazh, vetëm për të prodhuar një vepër që përputhej me standardin që vetë Regani kishte krijuar tashmë. Politikat e tij ishin të qarta. Ai i kishte artikuluar ato për dekada, derisa u bë President, ai shkroi vetë shumicën e materialit të tij.

Kur dëgjova Frau Elz-in të thoshte se Gorbaçovi duhet të hiqte qafe murin, e kuptova menjëherë se Presidenti do t'i ishte përgjigjur vërejtjes së saj. Dhe kur Departamenti i Shtetit dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare u përpoqën të bllokonin draftin tim duke paraqitur draftet alternative, ata e dobësuan çështjen e tyre. Fjalimet e tyre ishin të zbehta. Ata ishin burokratikë. Atyre u mungonte bindja. Njerëzit që i shkruan ato nuk kishin vjedhur, si unë, nga Frau Elz dhe nga Ronald Reagan.

*Peter Robinson, autor dhe ish-shkrues i fjalimeve të Shtëpisë së Bardhë, është anëtar në Institutin Hoover në Universitetin e Stanfordit. Në 1983, Robinson iu bashkua stafit të Presidentit Ronald Reagan, duke shërbyer pothuajse pesë vjet si shkrimtar fjalimesh dhe asistent special e Presidentit, një përvojë që ai e rrëfen në librin e tij të vitit 2003, “Si Ronald Regani ndryshoi jetën time”. Robinson i dha shefit ekzekutiv më shumë se 300 fjalime, duke përfshirë fjalimin e Murit të Berlinit të vitit 1987.*



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

# Nikolin Pici, gjurmë në fotografinë ushtarake shqiptare

## Në rrugën e një tradite

Shkodra, qytet i skajit verior të vendit, buzë liqenit të gjerë me të njëjtin emër, do afirmohej në shek. XX si kryeqyteti i fotografisë shqiptare. Këtu punuan pararendësit Pjetër Marubi (1834-1904), Kel Marubi (1870-1940), Kolë Idromeno (1860-1939). Shan Pici (1904-1976) është një nga emrat më të shquar të pasardhësve, i cili mësoi pranë Kel Marubit. Pas disa vitesh punë përgatitore, Shan Pici shkrep fotografinë e parë në studion e mjeshtrit të vet. Ishte 18 vjeç. Dy vjet më vonë, më 1924, hapi studion e tij me emrin "Peci". Si ndihmës kishte të vëllezërit, Ndrek dhe Tefë. Ndonëse realizonte portrete në studio dhe momente nga jeta e përditshme në Shkodër, ai interesohet veçanërisht për mënyrën e fotografimit të sporteve dhe të sportistëve. Kryesisht, ai do të zhvillonte një shije të posaçme për peisazhet e rrethinave dhe për jetën e vështirë të malësorëve. Në veri të Shkodrës, vëmendjen ia tërhiqnin krahina e Dukagjinit dhe bukuria e egër e bjeshkëve shqiptare. Duke ndjekur rrugën e më të moshuarve, ai dokumentoi jetën e Shkodrës gjatë viteve 1930, të familjeve të qytetit që vinin të pozonin bashkë me fëmijët e tyre. Ai botoi kartolina të shumta, të cilat i shpërndante përmes librarisë shkodrane Nikshiqi.

Në vitin 1949 fotografët do ta humbin pavarësinë. Pici u përpoq ta vijonte veprimtarinë e tij në bashkimet e kooperativave shtetërore, por me kush-tëzime të një natyre tjetër. Pikërisht në këtë vit, 1949, fotografët shkodranë u përjetësuan së bashku përpara objektivit dhe janë rreth Gegë Marubit, Shan Pici me Dedë Jakovën, brezi i mëvonshëm Pjetër Raboshta e Angjelin Nënshati. Koleksionet e negativave të këtyre pesë fotografëve ruhen sot në fototekën Marubi të Shkodrës. Shan Peci doli në pension në vitin 1962. Nikolin Pici, i biri i Shanit ka ndjekur gjurmët e babait të tij.

## Rruga drejt fotografisë

Mjeshtri i fotografisë Nikolin Pici lindi në Shkodër, më 24 tetor 1940. Familja Pici kishte traditë familjare, sepse i përkiste brezit të fotografëve shqiptarë të gjysmës së dytë të shek. XX. Nikolini duke qenë djali i fotografit të njohur shkodran Shan Picit, e mësoi artin e fotografisë nga babai në moshën 14 vjeç. Nikolin Pici u bë pjesë e familjes së madhe të fotografëve shkodranë dhe bëri emër në studion fotografike "Pici". U rrit, mësoi dhe u edukua në odën e burrave të shquar shkodranë, që quhej "Oda e territ". Prej kësaj ode dolën në dritë imazhe të fiksuara me personazhe nga më të ndryshmet të njerëzve të thjeshtë shqiptarë. Kur fëmijët, për vetë moshën e tyre, luanin në lagje dhe në ambiente të tjera futboll, Nikolini mori leksionet e para të fotografisë bardh e zi, puna e përditshme me babanë për të fotografuar njerëz



në studio dhe në terren në realizimin e peizazheve të ndryshme në natyrë. Puna e kujdesshme e babait krijoi pasionin për fotografinë tek Nikolini djalos, duke ruajtur në jetë dhuntinë prej artisti.

## Fotografoi për vite ushtinë shqiptare

Nikolin Pici pasi përfundoi akademinë shkodrane për foto, një ditë u bë pjesë e grupit të fotografëve të Laboratorit Fotografik Qendror të Ushtrisë Shqiptare. Në këtë grup bënin pjesë fotografë të tjerë të shquar si Petrit Ristani, Agron Kruti, Kosta Bej, Bujar dhe Alma Duka, të cilët kishin mësuar nga nxënësi i Gegë Marubit të madh, Rrok Berisha.

Misioni i tyre ishte që të dokumentonin veprimtarinë e stërvitjeve dhe të jetës në repartet e Ushtrisë Shqiptare. Ky staf fotografësh dhe laborantësh u bë pjesë e Laboratorit Qendror Fotografik të Ushtrisë Popullore. Ata lanë monument "Ditarin fotografik" të ushtrisë shqiptare të pas Luftës së Dytë Botërore, jetën intensive të saj, mësimet treguese, stërvitjet, qitjet luftarake, edukimin dhe mësimin e një ushtrie që stërvitej për mbrojtjen e vendit, paradat ushtarake dhe mjaft portrete të ushtarakeve shqiptarë.

Nikolini u bë pjesë e këtij stafi që në moshën 18-vjeçare. Në vitet 1959-1961, Pici ishte ushtar-fotograf dhe realizoi fotografinë e para dokumentare të ushtrisë popullore dhe pas 9 vjetësh (1961-1970) punë intensive me aparatën e tij, duke dhënë prova të mëdha artistike, kaloi fotograf i revistës ushtarake "10 Korriku" e cila ishte e ilustruar (1970-1990). Gjatë viteve 1983-1990, Nikolini vazhdoi punën në Laboratorin Fotografik të Ministrisë së Mbrojtjes, së bashku me mjeshttrin tjetër

të fotografisë, Alqi Gollosi. Të dy së bashku mbuluan shërbimin fotografik të gazetës "Luftëtari". Nikolin Pici shërbeu në Forcat e Armatosura të Shqipërisë për 31 vite. Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm janë krenarë me emrin e tij, të brezave të fotografëve që shërbyen me përkushtim dhe lanë të dokumentuar në foto vetë jetën dhe moshën e ushtrisë. Ai kujtohet me respekt dhe nga Ministria e Kulturës e Galeria Kombëtare e Arteve në Tiranë, ku Nikolini punoi në vitet 1990-2000. Emrin Nikolin Pici e gjen në mjaft botime të rëndësishme të ushtrisë shqiptare dhe të historisë së arteve pamore në Shqipëri.

## Dokumentoi stërvitjet e ushtrisë

Pas kryerjes të shërbimit ushtarak në vitin 1961 u bë pjesë e stafit profesionist të Laboratorit Qendror Fotografik të Ministrisë së Mbrojtjes. Në arkivin e laboratorit fotot e Nikolin Picit zënë një vend të rëndësishëm. Në mijëra fotot negativ e diapozitiv të dokumentuar shikon syrin e një profesionisti dhe fotografi serioz. Njëpërmjet fotove të tij, gjen imazhe nga stërvitjet e strukturave të ndryshme të Forcave të Armatosura shqiptare, veprimtari kulturore e artistike, gjendet gjithë jeta ushtarake. Në brendësi të kuadrantit të dokumentimit fotografik dhe të orientit të saktë ushtarak, fotografi, mjeshtër Pici ka gjetur hapësira dhe këndvështrimeve të spikatura dhe ka sjellë emocione realiste. Në fotografinë e tij gjenden portrete ushtarësh, marinarësh e pilotësh në detyra luftarake, në stërvitje dhe në kohën e lirë. Të gjitha fotot e tij pasqyrojnë mjaft bukur energjitë, vrellin, entuziazmin, burrërinë dhe bukurinë ushtarake e njerëzore.

Pici, gjatë punës në sektorin e

botimeve të Ministrisë së Mbrojtjes, ka realizuar dhe vepra të tjera fotografike në gjininë e peizazhit dhe portretit. Tradita familjare e lëvrimin të fotografisë bardh e zi, ka lënë gjurmë tek Nikolin Pici.

Ai arriti që me mjaft kujdes të kërkonte dhe të gjente bukurinë e "lojës" së dritë-hijes në natyrë. Në fotot peizazh të Nikolin Picit brenda tyre gjen magjinë e "të veçantës" fotografike, si bukurinë, delikateshën e imazhit dhe emocionet që të përcjell. Duke ruajtur me kujdes "talentin" në fotografinë klasike, ai kërkoi dhe solli me objektivin e tij bukurinë artistike të detajit, dhe duke i dhënë fotografisë emocione në përsosmëri.

Në shërbimet e shpeshta dhe në vende nga më të bukurat, të largëtat, ku ishin vendosur repartet ushtarake shqiptare, Pici ka fiksuar, përveç imazheve të ushtarakëve të veçantë, të gërshetuar edhe me magjinë e bukurisë të natyrës shqiptare. Veprat fotografike të Nikolin Picit kanë brenda tyre qetësi dhe dritë që jep në bukurinë e imazhit të fiksuar.

Edhe sot imazhet në fotot e Nikolin Picit iu ngjajnë sekuençave të filmave amerikanë në luftën në Kore dhe në Vietnam. Momenti që përcjellin të ndaluar në kohë, emocionet që ndjen kur shikon foton prej letre në bardhezi. Këto janë foto, janë imazhe të bëra në stërvitjet dhe mësimet treguese të strukturave të ndryshme të Forcave të Armatosura shqiptare, janë portrete të ushtarakëve këmbësorë, pilotë, marinarë, tankistë, artiljerë, xhenierë etj.

## Pas la gjurmë të historisë së ushtrisë

Mjeshtri Nikolin Pici është pjesë e grupit fotografit klasik shqiptar të viteve 1960-1990. U formua në studion e babait dhe ruajti me fanatizëm traditën

e mjeshtërve të fotografisë shqiptare të tillë si: Marubi, Radovani, Ristani. Jakova, Nënshati, Gollosi, Kallfa, Veseli. Ai ka qenë mik, shok dhe koleg me Alqi Gollosin, Petrit Kumin, Refik Veselin, Petrit Kumin, Besim Fushën dhe Leon Çikën.

Fotografite e tij, gjithashtu, ishin pjesë e mediave të kohës si revista "Ylli", "Shqiptarja e re", "Shqipëria sot" etj. Në vitin 1982, hapi ekspozitën e tij me 130 vepra fotografike me temë nga ushtria shqiptare. Si fotograf i Galerisë Kombëtare të Arteve në Tiranë dhe një kontribut në përvojën me dokumentimin e veprimtarive artistike dhe në botimet e galerisë si në katalogët "Ikona Shqiptare" (2001), "Monografi", "Thoma Thomai", (1997), revista "Pamorart" etj.

Ylli Drishti studiues dhe kurator arti ka theksuar se Nikolin Pici me fotografinë e tij ka kontribuar në albumet e botuara nga Ministria e Mbrojtjes deri në vitet 1990 dhe më tej në botime të tjera të veçanta për artin ikonografik.

Foto të tij në botime janë albumet "25 vjet Ushtri Popullore", "Marshon Shqipëria Socialiste", "Ushtria Popullore në artet figurative", "Ikona Shqiptare" (2001) dhe "Ikona bizantine dhe pas bizantine në Shqipëri" (2007) me autor Ylli Drishtin.

Artistët e fotografisë shqiptare gjejnë tek vepra e Nikolin Picit trashëgiminë e pasur dhe shumë planëshe. Fotografia shqiptare ka fiksuar në memorien e saj fotografinë e pasionuar dhe qytetarin korrekt Nikolin Pici, i cili është pjesë e historisë së plejadës së mjeshtërve të fotografisë shqiptare të shek. XX. Mjeshtri i fotografisë ushtarake Nikolin Pici edhe sot është figurë shembullore e njeriut të kompletuar.

# Filluan regjistrimet e kandidatëve për ushtarë/ detarë aktivë në FA për periudhën 12 shtator - 18 nëntor 2022 sipas rajoneve



## Qendra e Personel-Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura



**Q**endra e Personel-Rekrutimit ka filluar regjistrimin e kandidatëve

për ushtarë/detarë aktiv dhe kërkon të rekrutojë për periudhën 12.09.2022 - 18.11.2022, gjithsej 346 kandidatë, (332 meshkuj dhe 14 femra), sipas rajoneve përkatëse në tabelën bashkëlidhur.

*Për më Shumë Informacion drejtohuni tek linku i mëposhtëm:*

<https://www.mod.gov.al/.../5539-filluan-regjistrimet-e...>



**Q**endra e Personel-Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për

Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2022-2023, për 40 (dyzet) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimi universitar i përafrohet si vijon: Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike, IT, Telekomunikacion, Inxhinieri Informatike, Kompjuterike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik, Financë), Xhenio/Infrastrukturë (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Forcë Ajrore (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Jurist (Fakulteti i Drejtësisë), Transport (Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike), Këmbësori/Zbulim (Shkenca sociale/Fakultetet e tjera).

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit është deri më 11 gusht 2022.

*Për më Shumë Informacion drejtohuni tek linku i më poshtëm:*

<https://www.mod.gov.al/.../5540-qendra-e-personel...>